**Vendim i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë**

**"H.K HEC GRABOVA 2 Shpk"**

Nr. 4. date 28/07/2022

Sot me datë 28/07/2022, ortakët e shoqërisë "H.K HEC GRABOVA 2" Shpk e identifikuar me nr NUIS-I L72023004I, me seli në adresën Tiranë, Kashar, Mëzez, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.3, Rruga Themistokli Gërmenji, Zona Kadastrale 2679, Godina me nr pasurie 22/14 :

1. Shoqëria "HYDROPOWER" shpk, me NUIS K51828006W me ortak të vetëm Z. Lulzim Kapllanaj.
2. Shoqëria "Vellezerit Hysa" Shpk, me NUIS K12911201C me ortakët Znj.Flutura Hysa, me 40% të aksioneve, Z.Besnik Hysa, me 30% të aksioneve, Z.Kujtim Hysa, me 30% të aksioneve,

**Morën në shqyrtim rendin e ditës si më poshtë :**

a) Në Vendimin e Ortakëve nr.3 të datës 25/05/2022 "H.K HEC GRABOVA2" Shpk, palët kanë shprehur vullnetin për shit-blerjen e 1(një) kuote, që shoqëria "Hydropower" Shpk, zotëron si ortak në shoqërinë koncesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk dhe që përbën 50% të kapitalit "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, e cila do shitet tek blerësi shoqëria "The Best Construction" Shpk.

b) Në lidhje me transferimin e kuotës që "Hydropower" Shpk, zotëron si ortak në shoqërinë koncesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, për tek blerësi "The Best Construction"Shpk, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në cilësinë e Autoritetit Kontraktor me shkresën 12070/1 prot datë 14/07/2022, ka marrë dakortësinë e Ministrisë së Financave për miratim në parim të transferimit të kapitalit nga shitësi tek blerësi dhe me shkresën nr.4601/5 Prot, datë 25/07/2022, ka njoftuar "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, për miratimin e transferimit të kuotës.

c) Të diskutohet në lidhje me procesin e shitjes së 1-kuote që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "HK HEC GRABOVA 2 sh.p.k dhe që zotërohet nga ortaku Hydropower sh.p.k

d) Të merret pëlqimi përfundimtar i ortakut tjetër "Vellezerit HYSA" sh.p.k

e) Të nënshkruhet Kontrata e Shitjes se Kuotës para noterit , nga përfaqësuesit ligjor të shoqërive, respektive.

Pas diskutimeve të ortakëve respektive përfaqësues , dhe pasi ortaku "Vëllezërit Hysa " sh.p.k deklaroi përfundimisht qëndrimin e tij të mëparshëm se nuk ishte i interesuar të blinte 1-kuote që zotëron ortaku tjetër Hydropower shpk duke lejuar kështu përfundimisht shitjen e saj te persona të tretë juridik, asambleja e ortakëve të shoqërisë "H.K HEC GRABOVA 2" Shpk në unanimitet të plotë vendosi :

**<u>V E N D I M:</u>**

1) Sipas përmbajtjes, Rikonfirmimin e Vendimit te Ortakëve nr.3 të datës 25/05/2022 "H.K HEC GRABOVA2" Shpk, palët kanë shprehur vullnetin për shit-blerjen e 1(një) kuote, që shoqëria "Hydropower" Shpk, zotëron si ortak në shoqërinë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk dhe qe përbën 50% të kapitalit "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, e cila do shitet tek bleresi shoqëria "The Best Construction" Shpk.
2) Pranimin e autorizimit të transferimit të kuotës që "Hydropower" Shpk, që zotëron si ortak në shoqërinë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, për tek bleresi "The Best Construction"Shpk. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në cilësinë e Autoritetit Kontraktor me shkresën 12070/1 prot datë 14/07/02022, ka marrë dakortësinë e Ministrisë së Financave për miratim në parim të transferimit të kapitalit nga shitësi tek bleresi dhe me shkresën nr.4601/5 Prot, datë 25/07/2022, ka njoftuar "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, për miratimin e transferimit të kuotës.
3) U miratua pëlqimi përfundimtar i ortakut tjetër "Vëllezërit HYSA" sh.p.k
4) Të rikonfimohet shitja 1-kuote sipas Vendimit të Ortakëve nr.3 të datës 25/05/2022 "H.K HEC GRABOVA2" Shpk, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "HK HEC GRABOVA 2 sh.p.k dhe që zotërohet nga ortaku Hydropower sh.p.k tek bleresi "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk.

5) Të nënshkruhet Kontrata e Shitjes para Noterit, nga përfaqësuesit ligjor të shoqërive, respektive.

6) Të regjistrohet Kontrata e Shitjes se Kuotave ne QKB sipas ligjit me qëllim pasqyrimin e ortakut te ri "The Best Construction"Shpk në ekstraktin e shoqërisë "HK HEC GRABOVA 2"Shpk, si ortak me 1-kuotë ose 50% të kapitalit.

7) Ngarkohen Administratorët e shoqërisë HK HEC GRABOVA 2 shpk që të dy sëbashku personalisht ose nëpermjet përfaqësuesve të autorizuar , të ndjekin të gjithë procedurën ligjore deri në regjistrimin e Kontratës së Shitjes së Kuotës në QKB.

Ky vendim hartohet në 4-kopje , njera prej të cilave aplikohet në QKB dhe 3-tre të tjerat qëndrojne në arkivën respektive.

**Ky vendim firmoset nga ortakët:**

**"Hydropower" Shpk**

Z. Lulzim Kapllanaj

K51828006W
HYDROPOWER
SH.P.K
TIRANE - ALBANIA

**"Vëllezërit Hysa"Shpk**

Znj.Flutura Hysa

Z.Besnik Hysa

Z.Kujtim Hysa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER ALKET Z. MANÇKA**
**ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6**
**TEL: 693645101**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 4454** **Nr. koleksioni: 2911**

**Tirane më 29/07/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A20220514003241615

*Akti noterial përbëhet nga 7 fletë

PULLE TARIFE PULLE TARIFE

A2022051400324161545

REPUBLIKA E SHQIPERISE DHOMA E NOTERISE TIRANE ZYRA NOTERISE TIRANE

Nr.4454 Rep. Nr.311 Kol.

**KONTRATË SHITBLERJE (KUOTASH)**

Sot para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6, Tiranë, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 datë. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe nenin 10 të statutit të shoqërisë " HK HEC Grabove 2 "Shpk, për nënshkrimin e kësaj "kontratë për shitblerje kuotash" u paraqiten personalisht palët:

**Shoqëria "Hydropower" Shpk,** shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me NUIS K51828006W, me seli në Autostradën Tiranë-Durrës, Km 3, pas Universitetit Kristal, Rruga "Themistokli Germenji", Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, përfaqësuar nga Z. **Lulzim Kapllanaj**, atësia Isuf, i datëlindjes 15.11.1984, lindur në Fratar, Fier dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr. 030037956, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i autorizuar rregullisht me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të datës 12.05.2022, bashkëlidhur kësaj Kontrate si Shtojca A (më poshtë referuar si "Hydropower" ose "**SHITËSI**"). Kjo shoqëri është një nga dy ortakët e shoqërisë H.K HEC Grabova 2"Shpk me NIPT L72023004I, dhe zoteron një kuotë që përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë "H.K HEC Grabova 2"Shpk.

*dhe*

**Shoqëria "THE BEST CONSTRUCTION" Shpk,** me nr. NUIS K41510019W, me adresë të selisë: Rezidenca Sunrise Residencë, Rruga e Vilave, Godina Z2D1,D1, Kati 0, pranë TEG Farkë LUNDËR Tiranë, E-Mail: thebestco2000@gmail.com, e përfaqësuar nga administratori **Z.Agim Xhelilaj,** atësia Hamdi, i datëlindjes 22.06.1964, lindur në Durrës, dhe banues në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftim nr.036061336, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i autorizuar rregullisht me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të datës 25.05.2022, bashkëlidhur kësaj Kontrate si Shtojca C (më poshtë referuar si **"The Best Construction"** ose **"BLERËSI"**)

"Hydropower" Shpk dhe "The Best Construction" shpk referohen gjithashtu bashkërisht si; Shitësi dhe Blerësi ose si **"Palët"** dhe veç e veç si **"Pala"**;

**TË DHËNAT PARAPRAKE:**

A. Shitësit dhe Blerësi kanë nënshkruar Akt-Marrëveshje paraprake nr.2761 Rep & nr.1981 Kol, datë 28/05/2022 dhe Akt-Marreveshje Shtesë nr.2938 Rep & nr.2095 Kol, datë 06.06.2022.

B. Palët kanë shprehur vullnetin për shit-blerjen e 1(një) kuote, që shoqëria "Hydropower" Shpk zotëron si ortak në shoqërinë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk dhe qe

A2022051400324161545

përbën 50% të kapitalit "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, e cila do shitet tek blerësi shoqëria "The Best Construction" Shpk.

**C.** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në cilësinë e Autoritetit Kontraktor me shkresën 12070/1 prot datë 14/07/02022, ka marrë dakortësinë e Ministrisë së Financave për miratim në parim të transferimit të kapitalit nga shitësi tek blerësi dhe me shkresën nr.4601/5 Prot, datë 25/07/2022, ka njoftuar "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, për miratimin e transferimit të kuotës që "Hydropower" Shpk, zotëron si ortak në shoqërinë koncesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, për tek blerësi "The Best Construction" Shpk.

**D.** Kushtet thelbësore për realizimin e shitblerjes dhe rrjedhimisht të transferimit konkret nga Shitësi tek Blerësi të Kuotave të Kapitalit (më poshtë referuar edhe si "Transaksioni") janë përcaktuar tashmë nga Palët në Akt Marrëveshjen Paraprake, nënshkruar nr.2761 Rep & nr.1981 Kol, datë 28/05/2022 (më poshtë referuar si "Marrëveshja Paraprake") dhe ne Akt-Marrëveshjen Shtesë nr.2938 Rep&nr.2095Kol, datë 06.06.2022 (me poshte referuar si **shtojca)**

E. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate (më poshtë referuar si "Kontrata"), dhe pasi të jetë konstatuar plotësimi i të gjitha ngjarjeve, rrethanave, akteve, fakteve dhe situatave që përbëjnë Kushtet e Akt Marrëveshjes Paraprake, Palët kanë për qëllim të kryejnë Transaksionin, duke transferuar Kuoten e Kapitalit nga Shitësit tek Blerësi në zbatim të Marrëveshjes Paraprake.

F. Kjo Kontratë nuk nënkupton rinovim të kushteve kontraktore, deklaratave dhe garancive të marra përsipër përmes Marrëveshjes Paraprake. Palët bien dakord të vazhdojnë të zbatojnë të gjitha nenet e Marrëveshjes Paraprake dhe për të cilat nuk është hequr dorë shprehimisht në këtë Kontratë.

***Palët bien dakord për sa më poshtë:***

**Neni 1**
**Përkufizimet**

1.1. Premisat, Deklarimet dhe Shtojcat janë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate për shitjen e Kuotes të Kapitalit (më poshtë referuar si **"Kontrata"**) dhe kanë përcaktuar shprehjen e vullnetit.

1.2. **"Kontratë koncesionare"**: Nënkupton kontratën e formës "BOT" (ndërtim - operim - transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2", nënshkruar para noterit më datë 14.09.2017 , me nr.2026, Rep, nr.926/1 Kol dhe 3(tre) amendimet përkatëse përkatësisht nr.1356 Rep, nr.909/2 Kol, datë 22.06.2018, nr.806 Rep, nr.318 Kol, të datës

A20220514003241615 45

21.06.2020, dhe - Nr.1755 Rep. Nr. 599 Kol, me datë 16.07.2021, të cilat janë pjesë integrale e kësaj kontratës së konçesionit.

1.3. Autorizimi i Shitjes nga Autoriteti Kontraktor (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nr.4601/5 Prot, datë 25/07/2022, bashkëlidhur kësaj kontrate si **(Shtojca F).**

1.4. "Barrë"nënkupton çdo interes ose kapital të një personi (duke përfshirë çdo të drejtë për përfitim, mundësinë ose të drejtën e parablerjes) ose barrë hipotekore, detyrim, peng, barrë, transferim, hipotekim, barrë siguruese (duke përfshirë çdo barrë të krijuar me ligj), mbajtje e titujve të pronësisë apo çdo marrëveshje garancie apo transferimi ose qiradhënie, blerje me këste, shitje me kredi apo çdo marrëveshje tjetër;

1.5. "Çmimi Përfundimtar" Çmimi i Blerjes së Kuotave të Kapitalit, siç parashikohet në Nenin 2 pika 2.18, i përllogaritur nga Palët në bazë të dispozitave të Marrëveshjes Paraprake dhe Shtojces E;

**Neni 2**
**Objekti i Kontratës**

2.1. Me nënshkrimin e kësaj Kontratë Blerësi blen dhe Shitësi shet pronësinë e 1 (një) kuote, që zotëron shoqëria "Hydropower" Shpk si ortak në shoqërinë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk dhe qe përbën 50% të kapitalit te shoqërisë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, me NIPT L72023004I .

**Neni 3**
**Çmimi dhe Mënyra e Pagesës**

3.1. Çmimi Përfundimtar për blerjen e 1 (një) kuote, që zotëron shoqëria "Hydropower" Shpk, si ortak në shoqërinë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, dhe që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, për të cilin është rënë dakord sipas parashikimeve të Marrëveshjes Paraprake dhe Shtojces E, është në vlerën 1.800.000Euro (*një milion e tetëqind mijë*) Euro, konvertuar me kursin e këmbimit në datën e nënshkrimit të Akt Marreveshjes prej 210.204.000.00 Lekë (*dyqind e dhjetë million e dyqind e kater mijë*) lekë.

3.2. Modaliteti i pagesës së çmimit i referohet Akt Marrëveshjes dhe Shtojces E, sipas të cilave Blerësi ka parapaguar 200.000 Euro (dyqind mijë) euro, në llogarinë e Noterit si pjesë e çmimit të plotë të 1 (një) kuote dhe me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi do të paguaj diferencën e çmimit në vlerën 1.600.000 Euro (një milion e gjashtëqind mijë)euro, në llogarinë e Noterit brenda 3 (tre) ditëve pune nga nënshkrimi i kësaj

A2022051400324161545

kontrate, që sëbashku me këstin e parapaguar përbëjnë vlerën totale të çmimit të shitjes së kuotës. Pagesa nga blerësi, në llogarinë e noterit, do të bëhet në Euro.

3.3. Në këtë çmim nuk përfshihet cedimi i Huave me interes dhe pa interes që shoqëria "Hydropower" Shpk i ka dhënë "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, sipas kontratave:

a. *Kontratë Huaje - Nr.49 Prot, Grabova 2" Shpk & Nr.48 Prot. "Hydropower" Shpk, datë 09/02/2022 me vlerë 23.100.00 Euro (njëzet e tre mijë e qind) Euro, të vërtetuar me mandat bankar bashkëngjitur aktmarrëveshjes.*
b. *Kontratë Huaje - Nr.54Prot, Grabova 2" Shpk & Nr.53Prot."Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro, të vërtetuar me mandat bankar bashkëngjitur aktmarrëveshjes.*
c. *Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.*

Blerësi do të kryej pagesën për kontratat e mësiperme ne llogarine e shitesit, brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Shitësi shoqëria "Hydropower" Shpk, pasi likujdohet nga blerësi brenda 3 (tre) ditëve pune nga nënshkrimin i kësaj kontrate për kontratat e Huave me interes dhe pa interes që shoqëria "Hydropower" Shpk, i ka dhenë shoqërisë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, heq dorë përfundimisht dhe në mënyrë shteruese nga kërkimi në të ardhmen i të drejtës si kreditor për këto kredi/huadhënie ndaj shoqërisë konçesionare "HK HEC GRABOVA 2" Shpk, e drejtë e cila i cedohet Blerësit shoqërisë "The Best Construction" Shpk.

3.4. Krahas nënshkrimit të Kontratës së shitjes së kuotave dhe pagesës së këtyre huave "Hydropower" Shpk, nënshkruan kontratën e cedimit të huave me apo pa interes që shitësi "Hydropower" Shpk, i ka dhënë "HK HEC GRABOVE 2" Shpk, sikurse është parashikuar në pikën 2.6 të Akt Marrëveshjes.

3.5. Çmimi i shitjes i përcaktuar në nenin 3 pika 3.1, të kësaj kontrate, do të kalohet nga llogaria e Noterit në llogarië e shitësit, brenda 2(dy) diteve, pasi ky i fundit i është drejtuar me kërkesë me shkrim asamblesë së ortakëve të shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" Shpk, për kryerjen e aplikimit për regjistrim në QKB të kalimit të kuotës nga shitësi tek blerësi (penalitetet mbeten në fuqi po ato të pëcaktuara në Marrëveshjes Paraprake).

3.6. Çmimi i shitjes të kalohet nga llogaria e Noterit në llogarinë Bankare të Shitësit:

- **Banka:** **[Raiffeisen Bank]**
- Nr. Llog €: [00052 – 94544]
- Iban: [AL42 2021 1075 0000 0000 05294544]

A2022051400324161545

- Nr. Llog ALL: [00062 – 94544]
- Iban: [AL89 2021 1075 0000 0000 06294544]

3.7. Në rast se pala blerëse nuk kryen likujdimin e çmimit të shitjes dhe cedimin e kontratave të huasë, brenda 3 (tre) ditëve pune, bleresi do të paguaj penalitet 2 000 (dy mijë) Euro në ditë deri në ditën e 10 (dhjetë) dhe pas ditës së dhjetë do të penalizohet me një vlerë 200 000(dyqind mijë) Euro dhe ditën e njëmbëdhjetë kjo kontratë konsiderohet absolutisht e pavlefshme.

3.8. Në rast se pas aplikimit për regjistrim në QKB të kalimit të kuotës nga shitësi tek blerësi, QKB, kërkon plotësime të cilat duhet të nënshkruhen nga shitësi, ky i fundit paraqitet për nënshkrimin e plotësimeve brenda 3(tre) diteve që e kërkon blerësi, në rast se nuk parqitet ky i fundit paguan 2 000( dy mijë) euro për çdo ditë vonesë.

3.9. Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe pagimin e çmimit të plotë të shitjes nga blerësi, shitësi humbet kuotën që zotëronte në shoqërinë H.K HEC Grabova 2"Shpk dhe blerësi bëhet një nga ortakët e shoqërisë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, duke bërë edhe regjistrimin përkatës në QKB.

3.10. Më nënshkrimin e kësaj kontrate, dy kuotat e shoqërisë "H.K HEC Grabova 2"Shpk , ndahen në mënyrë të barabartë midis ortakëve si më poshtë vijon:

— Ortaku "Vëllezërit Hysa" Shpk, do të zotërojë 1 kuotë të kapitalit, ose 50% të kapitalit shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" Shpk.
— Ortaku "THE BEST CONSTRUCTION" Shpk, do të zotërojë 1 kuotë të kapitalit, ose 50% të kapitalit të shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" Shpk.

**Neni 4**
**Detyrimet e Palëve**

4.1. Shitësi pranon çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3 ,pika 3.1 dhe 3.2, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së pjesës së kapitalit objekt të kësaj kontrate , që ai kishte në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, pjesë e cila tashmë i kalon Blerësit.

4.2. Shitësi garanton se pjesa e tij në kapital, nuk është lënë peng, në dorëzani apo e rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi të.

4.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi pjesën e kapitalit objekt i kësaj kontrate, të drejta të cilat i transferohen Blerësit dhe ky i fundit shndërrohet në pronar me të drejta të plota mbi kuotat/pjesët e përcaktuar në këtë kontatë vetëm pasi të ketë likujduar çmimin e blerjes dhe cedimin e Huave.

A20220514003246154S

4.4. Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes dhe cedimin e Huave me interes dhe pa interes sipas kontratave të listuara në nenin 3.3 të kësaj kontrate sipas mënyrës dhe afatit të përcaktuar në këtë kontrate.

**Neni 5**
**Deklarimet dhe Garancitë**

5.1. Siç përcaktohet në të Dhënat Paraprake, kjo kontratë është në zbatim të Marrëveshjes Paraprake të nënshkruar midis Palëve e cila përveç nëse ka shprehimisht delegime, do të mbetet e vlefshme dhe efektive për të gjitha qëllimet, edhe pas nënshkrimit të kësaj Kontrate. Pavarësisht kësaj, duke qenë se Marrëveshja Paraprake parashikonte plotësimin e kushteve paraprake, përmbushja e të cilave përmbyllet nga Shitësi për Blerësin me dorëzimin e dokumenteve/deklaratave.
Shitësi deklaron dhe garanton që të gjitha dokumentet dhe autorizimet janë marre në rrugë ligjore dhe ato janë në përputhje me ligjin e zbatueshëm në formë dhe në përmbajtje.

**Neni 6**
**Të Ndryshme**

6.1. Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimit e tjera midis Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe duhet të dërgohen me postë me njoftim-marrje ose me email te adresat e Palëve të përmendura në hyrje të kësaj Kontrate, ose në çdo adresë apo numër faksi apo email tjetër që do të komunikohet me shkrim më vonë nga njëra Palë te tjera. Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim do të konsiderohet si i marrë: nëse dërgohet me faks, nga momenti që merret faksi; nëse dërgohet me postë me njoftim-marrje, nga data që rezulton në njoftim-marrjen; nëse dërgohet me email, dy ditë pune pas ditës së dërgimit.Kjo Kontratë do të jetë e detyrueshme për Palët.

6.2. Kjo Kontratë, duke përfshirë edhe shtojcat si pjesë përbërëse dhe e pandashme e saj,dhe "Marrëveshjen për Transferimin e Aksioneve" (Shtojca E) nuk nënkupton rinovim të marrëveshjeve të tjera me shkrim midis Palëve për objektin e përcaktuar në këtë Kontratë dhe nuk zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme me shkrim.

6.3. Titujt janë dhënë si referencë dhe vetëm për qëllime lehtësie dhe nuk duhet të kufizojnë apo të ndikojnë në përmbajtjen e dispozitave ë kësaj Kontrate apo interpretimin e saj.

6.4. Nëse, në ndonjë moment ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e ndarë nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme që do të respektojë, sa më shumë të jetë e mundur, qëllimin e Palëve në këtë Kontratë dhe, nëse është e lejueshme, kjo nuk do të ndikojë apo cenojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të kësaj Kontratë.

A20220514003241615455

## Neni 7
## Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

7.1. Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

7.2. Çdo mosmarrëveshje, konflikt apo pretendim që lind nga/ose në lidhje me këtë Kontratë, duke përfshirë vlefshmërinë, pavlefshmërinë, shkeljet ose zgjidhjen e saj gjykata kompetente do të jetë Gjykata Civile e Shkallës Së Parë Tiranë .

## Neni 8
## Shpenzimet

**7.3.** Në çdo rast, shpenzimet (noteriale ose të tjera) dhe taksat lidhur me transferimin e Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë do t'i ngarkohen të dyja palëve në përpjestim të drejtë.

## NENI 9
## SHTOJCAT

**Shtojca A** Vendim i Ortakëve të "Hydropower"Shpk Nr.3 të datës 12/05/2022.
**Shtojca B** Vendim i Ortakëve të "Vëllezerit Hysa" Shpk Nr.07 të datës 24/05/2022.
**Shtojca C** Vendim i Ortakëve "H.K HEC GRABOVA2" Shpk. Nr.3 të datës 5/05/2022.
**Shtojca D** Vendim i Ortakëve "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk –datë 25.05.2022,
**Shtojca E** Akt-marrëveshje paraprake nr.2761 Rep& nr.1981Kol, datë 28/05/2022 dhe Shtesë nr.2938Rep&nr.2095Kol, datë 06.06.2022.
**Shtojca F** Autorizimi i MIE për Transferimin e Kuotave të Kapitalit nr.4601/5 Prot, datë 25/07/2022;
**Shtojca N** Ekstraktet e subjekteve dhe Id Administratoreve.

Kjo Kontratë hartohet në 7 (shtatë) kopje me vlerë të njëjtë dhe në gjuhen shqipe, dhe pasi lexohet dhe gjendet në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve kontraktore, nënshkruhet prej tyre pa vërejtje.

## PALËT:

**SHITËSI:**
Shoqëria "Hydropower" Shpk
Administrator
**Z.Lulzim Kapllanaj**

**BLERËSI:**
Shoqëria "The Best Construction" Shpk
Administrator
**Z.Agim Xhelilaj**

HYDROPOWER SHPK TIRANE - ALBANIA

THE BEST CONSTRUCTION Sh.p.k TIRANA ALBANIA

NOTER
ALKET Z.MANCKA

Shtojca A.

**VENDIM**

**i Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "Hydropower" ShPK**

**Nr. 3 datë 12.05.2022**

Sot me datën 13.05.2022, Asambleja e Ortakëve të shoqerisë "Hydropower" ShPK, me NIPT K12911201C, regjistruar si person juridik më datë 07.06.2005, me NIPT K51828006W, mbështetur në Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqeritë Tregetare, në praninë e ortakut të vetëm Z. Lulzim Kapllanaj, zotërues 100% të kuotave të shoqërisë;

**VENDOSA:**

1.Të miratojë shitjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk," SHPK me nr. NIPT L72023004I :

a) një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, 1.800.000 euro (një milion e tetëqind mijë )euro, konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar publikuar nga B.Sh. në ditën e nënshkrimit në vlerën ekuivalente 217.080.000 Lekë ( dyqind e shtatëmbëdhjetë million e tetëdhjetë mijë) lekë.

b) cedimin e Huave me interes, sipas kontratave :

b.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100.00 Euro (njëzetë e tre mijë e njëqind) Euro;

b.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.

b) Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.

2.Të autorizojë administratorin e shoqerisë Z. Lulzim Kapllanaj, identifikuar numër personal, I41115138A, për nënshkrimin e Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

3.Një kopje të këtij vendimi, i bashkangjitet Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E ORTAKEVE**
**Shoqëria "Hydropower" Shpk.**
Lulzim Kapllanaj
**Ortak i Vetëm**

K51828006W HYDROPOWER SHPK TIRANE - ALBANIA

Shtojca D

**VENDIM**

**i Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "THE BEST CONSTRUCTION" ShPK**

**Datë 25.05.2022**

Sot me datën 25.05.2022, Asambleja e Ortakëve të shoqerisë "THE BEST CONSTRUCTION r" ShPK, me NIPT K41510019W, regjistruar si person juridik më datë 19/11/2001, mbështetur në Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqeritë Tregetare, në praninë e ortakut të vetëm Z. Agim Xhelilaj, zotërues 100% të kuotave të shoqërisë;

**VENDOSA:**

1.Të miratojë blerjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe atë të financuar nga shoqëria"Hydropower" Shpk , e cila zotëron në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk," SHPK me nr. NIPT L72023004I :

a) një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, 1.800.000 euro (një milion e tetëqind mijë )euro, konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar publikuar nga B.Sh. në ditën e nënshkrimit në vlerën ekuivalente 217.080.000 Lekë ( dyqind e shtatëmbëdhjetë million e tetëdhjetë mijë) lekë.

b) cedimin e Huave me interes dhe pa interes, sipas kontratave :

b.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100.00 Euro (njëzetë e tre mijë e njëqind) Euro;

b.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.

b) Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.

2.Të autorizojë administratorin e shoqerisë Z. Agim Xhelilaj, identifikuar numër personal, G40622110G, për nënshkrimin e Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

3.Një kopje të këtij vendimi, i bashkangjitet Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E ORTAKEVE**
**Shoqëria "THE BEST CONSTRUCTION" ShPK**
Agim Xhelilaj
**Ortak i Vetëm**

THE BEST CONSTRUCTION Sh.p.k BEST TIRANA ALBANIA

Shtojca C.

<u>VENDIM</u>

**I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " H.K HEC GRABOVA 2" Shpk me NIPT L72023004I**

**<u>Nr. 3datë 25.05.2022</u>**

Sot më datën 25.05.2022, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "H.K HEC GRABOVA 2"Shpk me NIPT L72023004I, mbështetur në Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqëritë Tregëtare, në praninë e ortakëve të kësaj shoqërie që zotërojnë përkatësisht "Vellezerit Hysa"Shpk, me NIPT K 12911201C, përfaqësuar nga ortakët e kësaj shoqërie që zoterojnë përkatësisht Flutura Hysa 40 % të kuotave, Besnik Hysa 30 %, të kuotave, Kujtim Hysa 30 %, të kuotave dhe "Hydropoëer"Shpk, me NIPT K51828006W, me 50 % të kuotave përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Lulzim Kapllanaj, me 50% të kuotave, zhvilloi mbledhjën e asamblesë me **këtë reud ditë:**

1.Shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga "Hydropower"Shpk, me NIPT K51828006W, për lejimin e shitjes e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huase me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk," Sh me nr. NIPT L72023004I.

2. Të miratoj oferten për lejimin e blerjes se një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huase me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk, me nr. NIPT L72023004I, nga subjekti "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr. NUIS K41510019W, përfaqësuar nga administratori Agim Xhelilaj. me anë të Kontratës së Shitjes së Kuotës nga shitesi tek bleresi.

3.Miratimin e kalimit të të gjithë të drejtave dhe detyrimeve shoqërisë "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr. NUIS K41510019W, që vinë si rjedhojë e cedimit të huave me interes sipas kontratave:

*3.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100.00 Euro (njëzet e tre mijë e qind) Euro;*

*3.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.*

*3.3 Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.*

Janë të pranishëm ortakët "Vëllezërit Hysa" Shpk , ortakët e kësaj shoqërie që zoterojnë përkatësisht Flutura Hysa 40 % të kuotave, Besnik Hysa 30 %, të kuotave, Kujtim Hysa 30 %, të kuotave dhe "Hydropower"Shpk, me NIPT K51828006W, me 50 % të kuotave përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Lulzim Kapllanaj, me 50% të kuotave.

Z. Lulzim Kapllanaj, kryen detyrën e kryesimit, të mbledhjes dhe mbasi konstaton praninë e tërë kapitalit themeltar të shoqërisë, e deklaron asamblenë të mbledhur ligjërisht dhe të aftë për të marrë vendime përsa parashikohet në rendin e ditës.

Ortakët e shoqërisë, mbështetur në statutin e shoqërisë dhe Ligjin 9901 /2008 " Për tregëtarët dhe shoqëritë Tregtare" me votim unanim.

K51828006W HYDROPOWER SHPK TIRANE - ALBANIA

**VENDOSËN:**

1.Të aprovojnë kërkesën për lejimin e "Hydropower" shpk, për shitjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk," SHPK me nr. NIPT L72023004I.

2. Të miratojë ofertën për lejimin e blerjes së një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk," Shpk me nr. NIPT L72023004I nga subjekti "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr. NUIS K41510019W, përfaqësuar nga administratori Agim Xhelilaj. me anë të Kontratës së Shitjes së Kuotës nga Shitësi tek Blerësi.

3. Miratimin e Cedimit të kalimit të të gjithë të drejtave dhe detyrimeve shoqërisë "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr. NUIS K41510019W, që vinë si rjedhojë e cedimit të huave me interes sipas kontratave:

*3.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100.00 Euro (njëzet e tre mijë e qind) Euro;*

*3.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.*

*3.3Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.*

4.Të autorizojnë administratorët e shoqërisë "H.K .HEC Grabova 2"Shpk, për të paraqitur kërkesën drejtuar MIE. Për dhënie miratimi/autorizimi për transferim kuotash që zotëron "Hydropower" Shpk me NIPT K51828006W, në shoqërinë konçesionare "*H.K HEC GRABOVA 2" Shpk* me NIPT L72023004I.

5.Kontrata përfundimtare e shitjes ndërmjet "Hydropower" shpk dhe blerësit do jetë e vlefshme dhe mund të bëhet vetëm pas dhënies së autorizimit për lejim shitje nga MIE .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Ortakët e Shoqërisë " H.K HEC GRABOVA 2" Shpk**

**"Vellezerit Hysa" Shpk**

**Flutura Hysa** Flutura Hysa

**Kujtim Hysa** Kujtim Hysa

**Besnik Hysa** Besnik Hysa

VH VELLEZERIT HYSA sh.p.k. NDERTIM-PRODHIM-IMP-EXP

**"Hydropower" Shpk.**

**Lulzim Kapllanaj**

HYDROPOWER SHPK K51828006W

shtojca B.

Adresa: Fshati "Banje e Re" Nj. Adm. Klos, Bashkia Cerrik, Albania.
E-mail: vhltd@yahoo.com; administrator@vellezerithysa.al; aurela.dollenga@vellezerithysa.al
Mob: +355 692093601 - Tel/fax: +355 542 47 154

**VENDIM**
**i Asamblesë së ortakevë të Shoqërisë "Vëllezërit Hysa" Shpk**
**Nr. 07 datë 24.05.2022**

Sot më datë 03.05.2022, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Vëllezerit Hysa" Shpk me NIPT K12911201C, mbështetur në Statutin e Shoqërise dhe Ligjin për Shoqëritë Tregetare, në praninë e ortakëve të kësaj shoqërie që zotërojnë, përkatësisht: Flutura Hysa 40 % të kuotave, Besnik Hysa 30 % të kuotave, Kujtim Hysa 30 % të kuotave, njëzeri;

**VENDOSËN:**

1. Të miratojnë kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Hydropower"Shpk, për shitjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimet e të gjitha të drejtave që rrjedhin nga kontratat e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk,"Shpk me nr. NIPT L72023004I :

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij ngarkohet administratori Besnik Hysa.

Një kopje të këtij vendimi, i bashkangjitet Akt Marreveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes se Kuotave.

Ky vendim firmoset nga ortakët.

**Ortakët e Shoqërise "Vëllezerit Hysa" Shpk**

| Flutura Hysa | Kujtim Hysa | Besnik Hysa |
|---|---|---|
| Flutura Hysa | Kujtim Hysa | Besnik Hysa |

NDERTIM-PRODHIM-IMP-EXP VH VELLEZERIT HYSA sh.p.k. NIPT: K12911201C ELBASAN-ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6
TEL: 693645101

# AKT - MARREVESHJE

Nr. repertori: 2761 Nr. koleksioni: 1981

Tirane më 28/05/2022

A20220514000221615863

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 10 fletë

A202205140022165863

## AKT MARRËVESHJE PARAPRAKE

**për shitje të kuotave të kapitalit themelar që "Hydropower" shpk zotëron në shoqërinë koncesionare "H.K HEC GRABOVA 2"Shpk**

Sot; më datë 28/05/2022, para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6, u paraqit personalisht:

**SHOQERIA "HYDROPOWER" SHPK,** regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K51828006W, me seli në adresë Autostrada Tirane Durres, Km. 3, Pas Universitetit Kristal, Rruga Themistokli Germenji, Zona Kadastrale Nr.2679, Nr.Pasurie 22/14, përfaqësuar nga Administratori **Z.LULZIM KAPLLANAJ**, atësia Isuf, amësia Ylmije, shtetas Shqiptar, lindur në Fratar, Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Alia 03910008; Nd. 8; H. 2; Ap. 26; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 15/11/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036489901 dhe nr. personal I41115138A, i mëposhtëquajtur **"SHITËSI"**

**SHOQERIA "THE BEST CONSTRUCTION" SHPK,** regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K41510019W, me seli në adresë Sunrise Residence, Rruga E Vilave, Godina Z2d1,D1, Kati 0, Prane Teg, përfaqësuar nga Administratori **Z.AGIM XHELILAJ**, atësia Hamdi, amësia Gjyzhi, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në TIRANË, me adresë Vilave 03910145; Nd. 51; H. 1; Farkë; Lundër; 1045; Tiranë, lindur më 22/06/1964, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036061336 dhe nr. personal G40622110G, i mëposhtëquajtur **"BLERËSI"**

A20220514002216I5I63

**TË DHËNAT PARAPRAKE:**

Ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor si dhe "H.K HEC GRABOVA 2"Shpk, në cilësine e konçesionarit, *është lidhur* kontrata e konçesionit e formës BOT për ndërtimin e hidroçentralit "Grabovë 2", me nr.2026, Rep, nr.926/1 Kol, datë14.09.2017 si dhe janë bërë 3(tre) amendime të saj *përkatësisht nr.1356 Rep, nr.900/2 Kol, datë 22.06.2018, nr.806 Rep, nr.318 Kol, të datës 21.06.2020, dhe - Nr.1755 Rep. Nr. 599 Kol,me datë 16.07.2021, të cilat janë pjesë integrale e kësaj kontrate konçesioni .*

**A)"HYDROPOWER".Shpk,** me NIPT K51828006W, është një nga dy ortakët e shoqërisë konçesionare "H.K HEC GRABOVA 2"Shpk dhe zotëron një kuotë që përbën 50 % të kapitalit të "H.K HEC Grabova 2"Shpk.

**B)"THE BEST CONSTRUCTION"Shpk,** me NIPT K41510019W, kryen aktivitet në fushën e ndërtimit, ndërtime civile e industriale dhe sipas planeve të saj të biznesit e meqenëse, ka kapitale të lira, ka planifikuar të zgjerojë aktivitetin e vet edhe në fushën e ndërtimit të hidrocentraleve.

Këto dy shoqëri kanë hyrë në bisedime verbale mbi mundësinë e shitblerjes së pjesës së plotë që "Hydropower"Shpk, zotëron në shoqerinë konçesionare "H.K HEC GRABOVA 2" Shpk.

**C)**Shitësi i ka paraqitur kërkesë asamblesë së ortakëve të shoqërisë konçesionare "H.K HEC GRABOVA 2"Shpk, për lejimin e "Hydropower"Shpk, për shitjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë konçesionare dhe ka marre miratimin e asamblesë së ortakëve.

**D)** Shitësi pranon cedimin e të gjitha të drejtave dhe detyrime që ai ka shoqëria konçesionare "H.K .HEC Grabova 2"Shpk dhe ka njoftuar ortakun tjetër shoqërinë"Vellezerit Hysa"Shpk, lidhur me ketë cedim nga "Hydropower"Shpk tek The "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, ku përfshihen edhe Huatë me apo pa interes si dhe të gjitha finacimet e bëra apo që mund të bëhen nga "Hydropower"Shpk në shoqërinë

A2022051400231615S63

konçesionare "H.K HEC GRABOVA 2"Shpk, deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotave para noterit, pasi MIE të ketë lejuar me autorizimin përkatës këtë shitje. (miratuar me Vendimin e Ortakëve të datës Nr.3 të datës 13/05/2022, që bashkëlidhet kësaj Akt-marrëveshje si Shtojca (A)).

E)Asambleja e ortakëve me Vendimin e datës Nr.3 të datës 25/05/2022, bashkëlidhur kësaj Akt-marrëveshje si Shtojca F) të shoqërisë konçesionare "H.K .HEC Grabova 2"Shpk, me vendim unanim ka miratuar kërkesën e shitësit për tu lejuar për shitjen e kuotës dhe miratimin e cedimit të Huave me interes dhe ato të financuara nga shoqëria, që ai ka në zotërim në shoqërinë konçesionare dhe pranimin e subjektit "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, si blerës.

F)Blerësi kërkon që shitësi të garantoj se kuotat e kësaj shoqërie të jenë të lira nga çdo lloj detyrimi dhe/ose barrë tjetër, të garantoj se i gjithë dokumentacioni dhe informacioni i dhënë nga shitësi për blerësin të jetë i qartë, i sinqertë, i sigurtë dhe i vërtetë prandaj kanë rënë dakord me shitësin, që të ndiqet një rrugë e mirëpërcaktuar dhe të kryhen një seri e caktuar veprimesh juridike, para se si dhe përfundimisht të kalohen kuotat nga Shitësi tek Blerësi, kundrejt mënyrës së pagesës së çmimit të blerjes sipas kontratës finale të ndryshimit të kuotave.

***Për qëllimet e mësipërme palët lidhin këtë marrëveshje paraprake, duke patur parasysh kushtet paraprake që kanë shoqëruar dhe do të shoqërojnë palët deri në lidhjen dhe nënshkrimin të kontratës finale të ndryshimit së kuotave të shoqërisë "H.K HEC GRABOVA 2" Shpk.***

**Neni 1 - Objekti i Akt-Marrëveshjes**:

Objekti i kësaj marrëveshje paraprake shitje do të jetë rregullimi i marrëdhënies juridike midis palëve dhe evidentimi i etapave, proçedurave që do të ndiqen, përcaktimi i akteve që do të përpilohen, si dhe përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve përkatëse për shkak të transferimit së 1 (një) kuote, e cila përbën 50% të kapitalit që zotëron ortaku shoqëria "Hydropower"Shpk, në shoqërinë koçesionare "HK HEC GRABOVA 2"Shpk, e cila do shitet tek blerësi shoqëria "The Best Construction"Shpk.

A20220514002216l5863

## Neni 2 – Përmbajtja e Marrëveshjes

Me qëllim që të realizohet objekti dhe qëllimi i lidhjes së kësaj akt marrëveshje paraprake shitje kuotash të kapitalit themeltar si dhe të përcaktohet çfarë përmbahet në kushtet paraprake, palët kanë rënë dakord si më poshtë për veprimet dhe aktet juridike konkrete:

2.1 Shitësi, pasi ka marre lejen edhe të ortakut tjeter të shoqërisë konçesionare, i ka venë në dispozicion dhe i ka mundësuar njohjen me të gjithë dokumentacionin e plotë ligjor, administrativ, financiar dhe teknik që dispenon konçesionari në plotësim të kërkesave të kontratës konçesionare që ai zotëron.

2.2 Shitësit i ka bërë të qartë palës Blerëse të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kontratës konçesionare në rast se ai do të bëhet zotërues i kuotave të shoqërisë konçesionare.

2.3 Shitësi e ka informuar blerësin për fazën aktuale ku ndodhet realizimi i detyrimeve të kontratës së konçesionit dhe më konkretisht për Vendimin e KKT nr.09Prot. datë 30/12/2021" Për miratimin e lejes së ndërtimit dhe se kjo leje është aktualisht në proçes zbardhje nga AZHT si dhe kërkesës së dokumetacionit shtesë që AZHT, ka kërkuar për vonesën në zbardhjen e saj.

2.4 Shitësi e ka njohur blerësin me situatën reale financiare të shoqërise konçesionare, shpenzimet e financimet e kryera nga ai deri në momentin e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshje si dhe mbetet i gatshem ti verë në dispozicion çdo dokument që ka lidhje me situaten financiare .

2.5 Shitësi i ka informuar lidhur me kontratat e lidhura në funksion të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e konçesionit, si psh kontratat me prodhuesin e turbinave, kontratat e shërbimit dhe projektimit si dhe çdo kontratë, akt marrëveshje tjetër. Këto kontrata janë venë në dispozicion të blerësit për tu njohur me afatet dhe penalitetet e parashikuara në to për moszbatim të detyrimeve duke e venë theksin veçanërisht tek kontrata me prodhuesin e turbinave Voith Austria.

2.6 Blerësi angazhohet të bejë pagesën e këstit të radhës për kontratën e lidhur ndërmjet "Voith Hydro GmbH & Co KG Austria" dhe shoqërisë konçesionare "H.K HEC GRABOVA 2"

A20220514002216S003

Shpk, në mënyrë që shitësi "Hydropower" Shpk, ("HK HEC GRABOVA 2"Shpk) të mos ketë penalitete sipas detyrimeve kontraktuale që vinë në zbatim të saj.

2.7 Shitësi e ka njohur blerësin për aplikimin e berë nga shoqëria koncesionare "H.K HEC GRABOVA 2" Shpk, tek Reifesien Bank Albania sha, për të marrë kredi deri në shumën 6 000 000 (gjashtë milion) euro dhe kushtet e kësaj kontrate kredie ku secili nga ortakët e shoqërise koncesionare është bashkëkredimarrës.

2.8 Shitësi i ka shpjeguar në detaje dhe venë në dispozicion dokumentacionin e plotë lidhur me mosmarrëveshjet me **"Emikel"Shpk,** dhe çështjet gjyqësore që janë duke u shqyrtuar në gjykatën administrative dhe atë civile, fazën aktuale proçeduriale ku ato ndodhen si dhe nevojën për përcaktimin dhe bashkërendimin mes përfaqësuesve aktual të autorizuar të shoqërisë koncesionare me përfaqësuesin që do të caktojë vetë blerësi .

2.9 Blerësi i ka deklaruar Shitësit se, zotëron të gjithë kapacitetet teknike, financiare, ekspertizën si dhe ka reputacionin dhe seriozitetin për të respektuar kushtet e kontratës Koncesionare dhe këto cilësi nuk do të jenë pengesë për të marrë autorizimin për shitje aksionesh tek Autoriteti Kontraktor.

2.10 Blerësi ka përgatitur të gjithë dokumentacionin që kërkohet të dorëzohet tek Autoriteti Kontraktor për të marrë lejen për transferim aksionesh.

2.11 Blerësi ka marrë informacion të mjaftueshëm për të njohur situatën dhe fazën ku ndodhet realizimi i detyrimeve që burojnë nga ligji dhe kontrata e koncesionit.

2.12 Blerësi njeh situatën reale finaciare të shoqerisë koncesionare deri në momentin e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshje, kontratat e lidhura nga shoqëria koncesionare dhe në çmimin e ofruar për blerje i është referuar kësaj situate reale finaciare, ska pretendime për situatën financiare të informuar nga shitësi.

2.13 Shoqëria Koncesionare nëpermjet 2(dy) administratorëve do ti drejtohet Autoritetit Kontraktor me kërkesën për të miratuar transferimin e aksioneve.

2.14 Palët kanë renë dakord se, me marrjen e Autorizmit nga Autoriteti Kontraktor dhe marrjes së ekstraktit të shoqërisë koncesionare "H.K HEC GRABOVA 2" Shpk, ku nuk reflektohet asnjë lloj barre apo sekuestroje konservative mbi kuotat e kësaj shoqërie, palët do të

A20220514002261586З

vazhdojnë me procedurën e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të transferimit të kuotave së shoqërisë "Hydropower"Shpk, për shitjen e 1(një) kuote që përbën 50 %, të kapitalit të "H.K HEC Grabova 2"Shpk, dhe që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower"Shpk, zotëron në shoqërinë "H.K.HEC Grabova 2"Shpk, sipas pikave të legjislacionit në fuqi.

2.15 Blerësi dhe Shitësi si palë të interesuara për këtë shitje kuotash angazhohen së bashku që të marrin Aprovim me shkrim prej autoritetit kontraktor MIE për miratimin e shitjes së kotave, në një kohë sa me të shkurtër që i shërben interesave të dy palëve.

2.16 Pas miratimit me shkrim prej autoritetit kontraktor MIE, palët paraqiten para noterit për nëshkrimin kontratës përfundimtare së shitjes së kuotave.

2.17 Me nënshkrimin e kontratës përfundimtare së shitjes së kuotave, vërtetimin e kryerjes së pagesës së çmimit të shitjes së një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe likujdimin e vlerave sipas kontratave të cedimit (Huave) me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, zotëron në subjektin"H.K HEC Grabova 2"Shpk, mund të vazhdohet me regjistrimin dhe pasqyrimin e transaksionit në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombetare të Biznesit , ku përfundimisht do të pasqyrohet Blerësi si ortak me 1(një) kuote që përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë "H.K HEC GRABOVA 2" Shpk. Për realizimin sa më sipër, do të sjell përfundimin e marrëdhënies juridike midis palëve dhe arritjen e qëllimit, sipas kësaj Akt Marrëveshje.

2.18 Me arritjen e marrëveshjes është fiksuar çmimi përfundimtar, i prerë, i pa ndryshueshëm në vlerën :1.800.000 euro (një milion e tetëqind mijë )euro, konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar publikuar nga B.Sh. në ditën e nënshkrimit në vlerën ekuivalente 217.080.000 Lekë (dyqind e shtatëmbëdhjetë million e tetëdhjetë mijë) lekë (vlerë e cila do të kalohet nga Blerësi, në llogarinë e noterit që me nënshkrimin e kësaj Akt-Marrëveshje, e cila është kusht për hyrjen në fuqi të saj. Vlera do të kalohet në llogarinë e Shitësit nga noteri në momentin e nënshkrimit të kontatës së shit-blerjes nga palët) dhe valuta e lëvrimit do të jetë ajo e pagesave në euro.

2.19 Palët deklarojnë cedimin e Huave me interes dhe pa interes sipas kontratave:

a)Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022 me vlerë 23.100.00 Euro (njëzet e tre mijë e qind) Euro, të vërtetuar me mandat bankar bashkëngjitur kësaj aktmarrëveshje

b) Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro, të vërtetuar me mandat bankar bashkëngjitur kësaj aktmarrëveshje.

c) Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.

2.20 Pas nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjës e regjistrimit në QKB të blerësit, asnjëra palë nuk ka më të drejtë të ngrejë pretendime të çfarëdo lloji ndaj palës tjeter, një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk 1(një) kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk,

2.21 Shitësi shoqëria "Hydropower"Shpk, heq dorë përfundimisht dhe në mënyre shteruese nga kërkimi deri në të sidhmen i të drejtës si kreditor për këto kredi/huadhënie ndaj shoqërisë koncesionare "HK HEC GRABOVA 2"Shpk, e drejtë e cila i cedohet Blerësit shoqërisë "The Best Construction"Shpk.

**Neni 3– Afati dhe përfundimi i Marrëveshjes. Penalitete**

***3.1.Në asnjë rast blerësi nuk mund të vazhdojë me procedurën e regjistrimit në QKB, nese nuk konfirmohet kryeja e pagesës e llogarinë bankare të shitësit.***

3.2Palët bien dakord se afati për kohëzgjatjen e Akt Marrëveshjes lidhet me realizimin e kënaqshëm të të gjitha veprime të përmendura në këtë Akt Marrëveshje, në përgjithësi dhe sidomos me miratimin nga MIE të autorizimit për shitjen e kuotave.

3.3Palët parashikojnë të drejtën reciproke të secilës palë të kësaj Akt Marrëveshje për tu dëmshpërblyer me një penalitet të barabartë me 200 000 *(dyqindmijë* ) €, nëse konstatohet e provohet se pala respektive (që obligohet në bazë të kësaj Akt Marrëveshje) nuk ka përmbushur një detyrim thelbësor që ka ndikuar në mosarritjen e qëllimit, sipas kësaj Akt Marrëveshje.

A2022051400221615801

I njëjti përcaktim vlen edhe kur vërtetohet se secila prej palëve ka kryer veprime ose mosveprime që kanë penguar në permbushjen e qëllimit final.

**Neni 4 – Të përbashkëta dhe zgjidhja e mosmarreveshjeve. Ligji aplikueshëm**

4.1Asnjëra nga palët nuk ka të drejte të bëjë ndryshime të njëanshme të kësaj Marrëveshje pa miratimin e palës tjeter. Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim .

4.2Çdo mosmarrëveshje që mund te lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet tyre, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.3Kjo Akt Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Zbatimi i saj dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me përmbajtjen apo ekzekutimin e saj do të bëhet në përputhje me ligjin shqiptar në fuqi.

**Neni 5 – Njoftimet dhe Forca Madhore**

5.1Çdo njoftim, kërkesë ose çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve, do të bëhet më shkrim duke patur parasysh që do të marrë vlerë pas marrjes në dorëzim nga pala tjetër ose personi i ngarkuar. Nëse palët kanë bërë me dije përfaqësues të posaçëm për marrjen dijeni, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme për komunikimin, atëhere të gjitha njoftimet do ti dërgohen përfaqësuesit të deklaruar.

5.2Palët nuk janë përgjegjësë për mospërmbushjen e detyrimeve të tyre, kur jemi përpara rasteve të Forcave madhore. Forca madhore nuk prezumohet, por duhet të vërtetohet lidhja e saj me pamundësinë objektive për ekzekutimin e detyrimit përkates. Mospërmbushja e detyrimeve nuk mund të zgjas më shumë se sa zgjat apo vazhdon forca madhore, përndryshe pala shkaktare mban përgjegjësi për të shlyer dëmin përkatëse.

5.3Pala që është apo gjëndet përballe një Forcë Madhore, që pengon realisht ekzekutimin e detyrimit përkatës, duhet të njoftoj palën tjetër për këtë shkak.

A20220514002216I5863

5.4Në rast të kundërt, Forca Madhore nuk do të konsiderohet shkak justifikues, në këtë kuptim. Gjithsesi, pala tjetër do të ketë të drejtën të verifikoj shkaqet e pretenduara, që përbëjnë Forcë Madhore, përveç rasteve kur një gjë e tillë përbën dukuri natyrore.

**Neni 6 – Konfidencialiteti**

6.1Kjo Akt Marrëveshje dhe kushtet e saj janë konfidenciale dhe asnjera prej palëve pjesëmarrëse nuk do zbuloj tek të tretët në menyre direkte dhe/ose të terthorte ekzistencën, kushtet e kësaj kontrate apo pjesë të caktuara të saj, përveç rastit kur të tretët kanë patur dijeni për një gjë të tillë për shkak të bërjes së ditur nga vetë palët për nevoja të përfaqësimit apo për shkak të methanave të posaçme dhe thelbësore, aplikimi i të cilave lidhet detyrimisht me arritjen e qëllimit final.

**Adresa Zyrtare dhe elektronike e komunikimit ndërmjet palëve do të jenë:**

**A.Për "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk,**

E-mail: *thebestco2000@gmail.com.*

**B. Për "HYDROPWER" Shpk,**

E-mail : *zyrajuridike@hydropower.al.*

**NENI 8 – SHTOJCAT**

| | |
|---|---|
| Shtojca A | Vendim i Ortakëve të "Hydropower"Shpk Nr.3 të datës 12/05/2022. |
| Shtojca B | Ofertë nga "Hydropower"Shpk-nr106 Prot date 13.05.2022. |
| Shtojca C | Vendim i Ortakëve të "Vëllezerit Hysa" Shpk Nr.07 të datës 24/05/2022. |
| Shtojca D | Shkresa nr.106Prot, datë 13/ 05/2022 nga "Vëllezerit Hysa" Shpk. |
| Shtojca E | Ofertë nga "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk - datë 25.05.2022. |
| Shtojca F | Vendim i Ortakëve "H.K HEC GRABOVA2" Shpk Nr.3 të datës 25/05/2022 |
| Shtojca F | Vendim i Ortakëve "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk -datë 25.05.2022. |
| Shtojca G | Ekstraktet e subjekteve dhe Id Administratoreve. |

A2022051480022815863

Kjo Akt Marrëveshje hartohet në 7(shtatë) kopje me vlerë të njëjtë dhe në gjuhën shqipe, dhe pasi lexohet dhe gjëndet në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve kontraktore, nënshkruhet prej tyre pa vërejtje.

**SHITËSI:** **SHOQËRIA "HYDROPOWER" SHPK**

**(Përfaqësuar nga Z.BULZIM KAPLLANAJ)**

**BLERËSI:** **SHOQËRIA "THE BEST CONSTRUCTION" SHPK**

**(Përfaqësuar nga Z.AGIM XHELILAJ)**

**NOTER**

**ALKET Z.MANCKA**

VENDIM

i Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "Hydropower" ShPK

Nr. 3 datë 12.05.2022

Sot me datën 13.05.2022, Asambleja e Ortakëve të shoqerisë "Hydropower" ShPK, me NIPT K12911201C, regjistruar si person juridik më datë 07.06.2005, me NIPT K51828006W, mbështetur në Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqeritë Tregetare, në praninë e ortakut të vetëm Z. Lulzim Kapllanaj, zotërues 100% të kuotave të shoqërisë;

VENDOSA:

1.Të miratojë shitjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk," SHPK me nr. NIPT L72023004I :

a) një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, 1.800.000 euro (një milion e tetëqind mijë )euro, konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar publikuar nga B.Sh. në ditën e nënshkrimit në vlerën ekuivalente 217.080.000 Lekë ( dyqind e shtatëmbëdhjetë million e tetëdhjetë mijë) lekë.

b) cedimin e Huave me interes, sipas kontratave :

b.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100.00 Euro (njëzetë e tre mijë e njëqind) Euro;

b.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.

b) Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.

2.Të autorizojë administratorin e shoqerisë Z. Lulzim Kapllanaj, identifikuar numër personal, I41115138A, për nënshkrimin e Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

3.Një kopje të këtij vendimi, i bashkangjitet Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E ORTAKEVE**

**Shoqëria "Hydropower" Shpk.**

Lulzim Kapllanaj

**Ortak i Vetëm**

K51828006W HYDROPOWER SHPK TIRANE - ALBANIA

Shqyrtoi. Dorëzoi Hysa
në datë 19.5.2022.

**HYDROPOWER**
**Sh.p.k**

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 3, pas Universitetit Kristal, Rr. Themistokli Germenji, Tiranë Albania
NIPT K51828006W Tel: 00355 42414022 Fax: 00355 42414023

Nr.106Prot

**Tiranë, më datë:13/ 05/2022**

**Lënda:** OFERTË, PËR BLERJEN E KUOTAVE NË PRONËSI TË SHOQËRISË "HYDROPOWER"SHPK, SI ORTAK NË VLERËN 50% TË AKSIONEVE, NË SHOQËRINË "H.K HEC GRABOVA2"SHPK.

**Drejtuar:** Shoqërisë "Vellezerit Hysa" Shpk, me NIPT K12911201C,
*Fshati "Banjë e Re" Nj. Adm. Klos, Bashkia Cerrik, Albania*

*Të Nderuar,*

**Shoqëria "Hydropower"Shpk,** me NUIS K51828006W, përfaqësuar nga Z.Lulzim Kapllanaj, zotëron 50 % (pesëdhjete përqind) kuotës e të kapitalit të shoqërisë "H.KHEC Grabova 2"Shpk, regjistruar në QKB me NIPT: "L72023004I" përfaqësuar nga Z.Lulzim Kapllanaj dhe Znj. Aurela Dollenga, krijuar me qëllim "Ndërtimin e Hidroçentralit "Grabovë 2" mbi pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në qarkun Elbasan", në zbatim të Kontratës Konçesionare të formës BOT, për ndërtimin e hidroçentralit "Grabovë 2", me Nr. 2026, Rep, Nr. 926/1 Kol. datë14.09.217, me Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Shoqëria "Hydropower"Shpk, ka vendosur të shes kuotat dhe cedimet e te gjitha te drejtave si Hua me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk, me nr. NIPT L72023004I, mbështetur dhe në statutin e shoqërisë neni 10 "Transferimi kuotave" si dhe në ligjin 9901, datë 14/04/2008 *"Për Shoqëritë Tregtare dhe Tregtarët"* si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në të cilin mbështetet Kontrata e Konçesionit.

Ju paraqesim ofertën tonë (shoqërisë "Vellezerit Hysa" Shpk), në cilësinë e parablerësit për kuotat që zotëron në shoqëri dhe dhe cedimin e Huave me interes dhe atë të financuar nga shoqëria deri tani, **si mëposht:**

a)një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, **në vlerën 1.800.000 euro (një milion e tetëqind mijë) euro,** konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar publikuar nga B.Sh. në ditën e nënshkrimit në vlerën ekuivalente **217.080.000 Lekë ( dyqind e shtatëmbëdhjetë milion e tetëdhjetë mijë) lekë.**

b) cedimin e Huave me interes, sipas kontratave:
b.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, **me vlerë 23.100.00 Euro (njëzetë e tre mijë e njëqind).**

b.2 Kontratë Huaje Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, **me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.**

b) Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.

**Sa më sipër: ju kërkoj që Brenda afatit 10- ditor, shpreheni për pranoni ose jo ofertën e propozuar nga ana jonë.**

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Për shoqërinë "Hydropower" Shpk**
Lulzim Kaplanaj
Administrator

Shqipja 1

Adresa: Fshati "Banje e Re" Nj. Adm. Klos, Bashkia Cerrik, Albania.
E-mail: vhkl@yahoo.com; administrator@vellezerithysa.al;
aurela.dollenga@vellezerithysa.al
Mob: +355 692093601 - Tel/fax: +355 542 47 154

**VENDIM**
**i Asamblesë së ortakevë të Shoqërisë "Vëllezërit Hysa" Shpk**
**Nr. 07 datë 24.05.2022**

Sot më datë 03.05.2022, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Vëllezerit Hysa" Shpk me NIPT K12911201C, mbështetur në Statutin e Shoqërise dhe Ligjin për Shoqëritë Tregetare, në praninë e ortakëve të kësaj shoqërie që zotërojnë, përkatësisht: Flutura Hysa 40 % të kuotave, Besnik Hysa 30 % të kuotave, Kujtim Hysa 30 % të kuotave, njëzeri;

**VENDOSËN:**

1. Të miratojnë kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Hydropower"Shpk, për shitjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimet e të gjitha të drejtave që rrjedhin nga kontratat e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk,"Shpk me nr. NIPT L72023004I :

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij ngarkohet administratori Besnik Hysa.

Një kopje të këtij vendimi, i bashkangjitet Akt Marreveshjes Paraprake dhe Kontratës së Shitblerjes se Kuotave.

Ky vendim firmoset nga ortakët.

**Ortakët e Shoqërise "Vëllezerit Hysa" Shpk**

| **Flutura Hysa** | **Kujtim Hysa** | **Besnik Hysa** |
| --- | --- | --- |
| Flutura Hysa | Kujtim Hysa | Besnik Hysa |

NDERTIM-PRODHIM-IMP-EXP VH VELLEZERIT HYSA sh.p.k. NIPT: K12911201C ELBASAN-ALBANIA

Aneks 1

Mjeftuar më datë 24/05/2022
Esmiralda Hysa
24/05/2022

Adresa: Fshati "Baraje e Re" Nj. Adm. Klos, Bashkia Cerrik, Albania.
E-mail: vhltd@yahoo.com; administrator@vellezerithysa.al;
aurela.dollenga@vellezerithysa.al
Mob: +355 692093601 - Tel/fax: +355 542 47 154

Nr.XI.Prot, Tiranë, më datë:24/ 05/2022

**Lënda:** Kthim përgjigje shkresës suaj nr.106Prot, datë 13/ 05/2022.

**Drejtuar:** Shoqërisë "Hydropower"Shpk, me NUIS K51828006W
Tiranë-Durrës, Km 3, Rr. Themistokli Germenji, Tiranë,

*Të Nderuar......,*

**Shoqëria "Vëllezerit Hysa" Shpk, me NIPT K12911201C**, në cilësinë e parablerësit, zoteron 50 % (pesëdhjete përqind) kuotës e të kapitalit në shoqërisë "H.KHEC Grabova 2"Shpk, regjistruar në QKB me NIPT: "L72023004I" përfaqësuar nga Z.Lulzim Kapllanaj dhe Zaj. Aurela Dollenga, krijuar me qëllim "Ndërtimin e Hidroçentralit "Grabovë 2" mbi pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në qarkun Elbasan", në zbatim të Kontratës Konçesionare të formës BOT, për ndërtimin e hidroçentralit "Grabovë 2", me Nr. 2026, Rep, Nr. 926/1 Kol. datë14.09.217, me Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Referuar ofertës së propozuar nga ana juaj, shprehim mos pranimin dhe nuk jemi të interesur për blerjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk," SHPK me nr. NIPT L72023004I.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Për shoqërinë "Vëllezerit Hysa" Shpk
Kujtim Hysa
Administrator
Bashkim Hysa

Shtojca [illegible]

Tiranë, më datë:25/ 05/2022

**OFERTË**

**Lënda:** Për Blerjen e Kuotave në Pronësi shoqërisë "Hydropower"Shpk, si ortak 50 % kuotës e të kapitalit që zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk.

**Drejtuar:** Shoqërisë "Hydropower"Shpk, me NUIS K51828006W
*Tiranë-Durrës, Km 3, Rr. Themistokli Germenji, Tiranë,*

*Të Nderuar,*

**Shoqëria "THE BEST CONSTRUCTION:Shpk,** me nr. NUIS K41510019W, me adresë të selisë: rezidenca Sunrise Residence, Rruga e Vilave, Godina Z2D1,D1, Kati 0, pranë TEC, Farkë LUNDER Tiranë, E-Mail: thebestco2000@gmail.com ; Telefon: 04250621, e përfaqësuar nga administratori Agim Xhelilaj, është informuar në lidhje me vendimin e shoqërisë "Hydropower"Shpk, për shitjen një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk dhe dhe cedimin e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, të cilën e zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk.

Sa më sipër: Ju paraqesim ofertën tonë **si mëposht:**

a)një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, në vlerën 1.800.000 euro (një milion e tetëqind mijë) euro, konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar publikuar nga B.Sh. 217.080.000 Lekë ( dyqind e shtatëmbëdhjetë million e tetëdhjetë mijë) lekë.

b) cedimin e Huave me interes, sipas kontratave:
b.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100.00 Euro (njëzetë e tre mijë e njëqind).
b.2 Kontratë Huaje Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.

b) Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Për shoqërinë "THE BEST CONSTRUCTION:Shpk**
Agim Xhelilaj
Administrator

THE BEST CONSTRUCTION SH.P.K
BEST
TIRANA ALBANIA

**VENDIM**

**I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " H.K HEC GRABOVA 2" Shpk me NIPT L72023004I**

**Nr. 3datë 25.05.2022**

Sot më datën 25.05.2022, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "H.K HEC GRABOVA 2"Shpk me NIPT L72023004I, mbështetur në Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqëritë Tregëtare, në praninë e ortakëve të kësaj shoqërie që zotërojnë përkatësisht "Vellezerit Hysa"Shpk, me NIPT K 12911201C, përfaqësuar nga ortakët e kësaj shoqërie që zoterojnë përkatësisht Flutura Hysa 40 % të kuotave, Besnik Hysa 30 %, të kuotave, Kujtim Hysa 30 %, të kuotave dhe "Hydropoëer"Shpk, me NIPT K51828006W, me 50 % të kuotave përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Lulzim Kapllanaj, me 50% të kuotave, zhvilloi mbledhjën e asamblesë me **këtë rend ditë:**

1.Shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga "Hydropower"Shpk, me NIPT K51828006W, për lejimin e shitjes e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huase me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk," Sh me nr. NIPT L72023004I.

2. Të miratoj oferten për lejimin e blerjes se një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huase me interes dhe atë të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk, me nr. NIPT L72023004I, nga subjekti "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr. NUIS K41510019W, përfaqësuar nga administratori Agim Xhelilaj. me anë të Kontratës së Shitjes së Kuotës nga shitesi tek bleresi.

3.Miratimin e kalimit të të gjithë të drejtave dhe detyrimeve shoqërisë "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr, NUIS K41510019W, që vinë si rjedhojë e cedimit të huave me interes sipas kontratave:

*3.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23,100.00 Euro (njëzet e tre mijë e qind) Euro;*

*3.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.*

*3.3 Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.*

Janë të pranishëm ortakët "Vëllezërit Hysa" Shpk , ortakët e kësaj shoqërie që zoterojnë përkatësisht Flutura Hysa 40 % të kuotave, Besnik Hysa 30 %, të kuotave, Kujtim Hysa 30 %, të kuotave dhe "Hydropower"Shpk, me NIPT K51828006W, me 50 % të kuotave përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Lulzim Kapllanaj, me 50% të kuotave.

Z. Lulzim Kapllanaj, kryen detyrën e kryesimit, të mbledhjes dhe mbasi konstaton praninë e tërë kapitalit themeltar të shoqërisë, e deklaron asamblenë të mbledhur ligjërisht dhe të aftë për të marrë vendime përsa parashikohet në rendin e ditës.

Ortakët e shoqërisë, mbështetur në statutin e shoqërisë dhe Ligjin 9901 /2008 " Për tregëtarët dhe shoqëritë Tregtare" me votim unanim.

**VENDOSËN:**

1.Të aprovojnë kërkesën për lejimin e "Hydropower" shpk, për shitjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk," SHPK me nr. NIPT L72023004I.

2. Të miratojë ofertën për lejimin e blerjes së një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe ato të financuar nga shoqëria, që përfaqëson të gjithë pjesën që "Hydropower" Shpk, zotëron në shoqërinë "H.KHEC Grabova 2"Shpk," Shpk me nr. NIPT L72023004I nga subjekti "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr. NUIS K41510019W, përfaqësuar nga administratori Agim Xhelilaj. me anë të Kontratës së Shitjes së Kuotës nga Shitësi tek Blerësi.

3. Miratimin e Cedimit të kalimit të të gjithë të drejtave dhe detyrimeve shoqërisë "THE BEST CONSTRUCTION"Shpk, me nr. NUIS K41510019W, që vinë si rjedhojë e cedimit të huave me interes sipas kontratave:

*3.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100.00 Euro (njëzet e tre mijë e qind) Euro;*

*3.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.*

*3.3Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720,000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.*

4.Të autorizojnë administratorët e shoqërisë "H.K .HEC Grabova 2"Shpk, për të paraqitur kërkesën drejtuar MIE. Për dhënie miratimi/autorizimi për transferim kuotash që zotëron "Hydropower" Shpk me NIPT K51828006W, në shoqërinë koncesionare "*H.K HEC GRABOVA 2" Shpk* me NIPT L72023004I.

5.Kontrata përfundimtare e shitjes ndërmjet "Hydropower" shpk dhe blerësit do jetë e vlefshme dhe mund të bëhet vetëm pas dhënies së autorizimit për lejim shitje nga MIE .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Ortakët e Shoqërisë " H.K HEC GRABOVA 2" Shpk**

**"Vellezerit Hysa" Shpk**

**Flutura Hysa** Flutura Hysa

**Kujtim Hysa** Kujtim Hysa

**B[illegible]**

VH VELLEZERIT HYSA sh.p.k. ELBASAN-ALBANIA

**"Hydropower" Shpk.**

**Lulzim Kapllanaj**

K51828006W HYDROPOWER SHPK TIRANE - ALBANIA

**VENDIM**

**I Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë "THE BEST CONSTRUCTION" ShPK**

**Datë 25.05.2022**

Sot me datën 25.05.2022, Asambleja e Ortakëve të shoqerisë "THE BEST CONSTRUCTION r" ShPK, me NIPT K41510019W, regjistruar si person juridik më datë 19/11/2001, mbështetur në Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqeritë Tregetare, në praninë e ortakut të vetëm Z. Agim Xhelilaj, zotërues 100% të kuotave të shoqërisë;

**VENDOSA:**

1.Të miratojë blerjen e një kuote që përbën 50 % të kapitalit dhe cedimin e Huave me interes dhe atë të financuar nga shoqëria"Hydropower" Shpk , e cila zotëron në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk," SHPK me nr. NIPT L72023004I :

a) një kuote që përbën 50 % të kapitalit në shoqërinë "H.K HEC Grabova 2"Shpk, 1.800.000 euro (një milion e tetëqind mijë )euro, konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar publikuar nga B.Sh. në ditën e nënshkrimit në vlerën ekuivalente 217.080.000 Lekë ( dyqind e shtatëmbëdhjetë million e tetëdhjetë mijë) lekë.

b) cedimin e Huave me interes dhe pa interes, sipas kontratave :

b.1 Kontratë Huaje- Nr.49Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.48Prot. "Hydropower".Shpk, datë 09/02/2022, me vlerë 23.100,00 Euro (njëzetë e tre mijë e njëqind) Euro;

b.2 Kontratë Huaje- Nr.54Prot, Grabova 2"Shpk & Nr.53Prot. "Hydropower".Shpk, datë 16/02/2022, me vlerë 100,000.00 Euro (njëqind mijë) Euro.

b) Cedimin e financimit në formë huaje pa interes në vlerën 7.720.000 Lekë (shtatë million e shtatëqind e njëzetë mijë ) lekë.

2.Të autorizojë administratorin e shoqerisë Z. Agim Xhelilaj, identifikuar numër personal, G40622110G, për nënshkrimin e Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

3.Një kopje të këtij vendimi, i bashkangjitet Akt Marrëveshjes Paraparake dhe Kontratës së Shitblerjes së Kuotave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E ORTAKEVE**
**Shoqëria "THE BEST CONSTRUCTION" ShPK**
Agim Xhelilaj
**Ortak i Vetëm**

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K51828006W |
| 2. Data e Regjistrimit | 07/06/2005 |
| 3. Emri i Subjektit | HYDROPOWER |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 03/06/2005 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 03/06/2005 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane - Durres, Km. 3, pas Universitetit Kristal, Rruga Themistokli Germenji, zona kadastrale nr.2679, nr.pasurie 22/14 |
| 8. Kapitali | 370,000,000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import eksport,tregetim te artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve,me shumice e pakice.Tregetim automjetesh te cdo lloji, marka tonazhi si dhe pjese kembimi per to.Tregetim karburantesh dhe vajrash me pakice.Transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit.Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.Tregetim te lendeve te para gjysem fabrikate.Tregetim materiale ndertimi.Hapje hotelesh. Shoqeria gjithashtu mund te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem te saj.Ndertime civile dhe pallate shumekateshe, ndertime ushtarake dhe rruge. Import, eksport materiale ndertimi dhe elektrike, servise dhe riparime te makinerive te renda dhe pjeseve te tyre. Shitje eskavatoresh me zinxhir ose goma, shitje autobotesh, shitje fadromash e traktoresh me zinxhire ose goma, shitje te ngarkuesave (fadroma) e bartes inertesh (kamiona) per perdorim te vecante ne miniera nentokesore, te cdo marke, fuqie motorrike e tonazhi, te rinj e te perdorur. Shitje gomash te cdo lloji marke e permase, furnizim e shitje pompash hidraulike e pneumatike, te cdo lloji permase e fuqie, per eskavatore, kamiona, fadroma, traktore, makineri minierash nentokesore e mjete normale rrugore si dhe antifrizë, alkoli frenash e bateri per te gjitha mjete e renda dhe ato rrugore. Shitje e furnizim me graso te cdo lloj densiteti e cilesie, kushineta te cdo madhesie, permase ku |

| | |
|---|---|
| | perfshihen edhe kushinetat per perdorim te vecante industrial si TEC-e, HEC-e, miniera, industri transportuesish me shirita etj. Testime, riparime dhe servis per sisteme hidraulike dhe pompa hidraulike. Ndertimin dhe menaxhimin e çdo godine, qendra biznesi, hotele, bar-restorante, magazina, parking, koomplekse turistike me karakter argetues, ndertimin, operimin dhe transferimin e energjise se rinovueshme dhe punime, kanalizime per rrjetet e jashtme dhe te brendshme te ujesjellesve e te çdo rrjeti tjeter të sistemit hidrik. Veprimtari ekonomiko-juridike ne fushen e energjitikes, duke percaktuar, por pa kufizuar veprimet e paperfendura: krijimi i sistemeve elektroenergjitike, prodhim, import-eksport te energjise elektrike me te gjitha format qe njeh teknologjia, duke permendur Panelet diellore, Mullinjte e eres, ndertimin e Hidrocentraleve, mbi burimet hidrike te lejuara nga organet kompetente. Shit-blerjen e energjise elektrike tek operatoret lokal apo nderkombetar, sipas legjislacionit dhe lejeve te organeve kompetente. Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te reja ose te perdorura, te autorizuara nga prodhuesi. Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio. |
| 10. Administratori/ët<br>10.1 Afati i emërimit | Lulzim Kapllanaj<br>Nga: 07/07/2021 — Deri: 07/07/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore<br>11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | |
| 12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)<br>12.1 Afati i emërimit | Artan Golemi<br>Nga: 15/12/2015 — Deri: |
| 13. Ortakët | LulzimKapllanaj |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 370.000.000,00 — Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 100,00 |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Fier MBROSTAR URA MBROSTAR URA Autostrada Tiranë - Fier, fshati Mbrostar - Ura, zona kadastrale 2636, volum 13 fq. 109, pasuria nr. 72/46 Tirane Tirane TIRANË<br>Minifurgon, marka Dacia me targa AA 873 OX |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: HYDROPOWER<br>E-Mail: info@hydropower.com.al<br>Telefon: 0674060002 0672080807 |

| | |
|---|---|
| | |
| 16. Statusi: | Aktiv |

Datë: 28/05/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K41510019W | |
| 2. Data e Regjistrimit | 04/03/2004 | |
| 3. Emri i Subjektit | THE BEST CONSTRUCTION | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 19/11/2001 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 19/11/2001 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Farke LUNDER Sunrise Residence, Rruga e Vilave, Godina Z2D1,D1, Kati 0, prane TEG | |
| 8. Kapitali | 78.100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 78.100,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ndertim dhe zbatim per: Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, prodhim materiale inerte, rere, çakull, gure, mermer, prodhim elementesh te parafabrikuar betoni e b/arme, prodhim elementesh te paranderur dhe armocementi, prodhime druri metalike, ndertime civile dhe ekonomike, industriale, turistike, bujqesore mbi dy kate dhe kompletim me instalimet e nevojshme per to.Ndertim ujesjellesa e kanalizime ,vepra kullimi,ujitje e vaditese.Punime karpentiere.Rikonstruksion godinash civile e ekonomike.Tregim m shumice dhe pakice ,brenda dhe jashte vendit .Makineri ,pajisje material e lende ndertimi,pajisje hidrosanitere dhe atrecatura te ndryshem etj.Sherbime ne autosrevise,eksport import pjese kembimi autovetura ,pajisje oficine dhe lavazhe ,sektorin e ushqimit social si bar bufe,restorante,hoteleri ,agjensi ,sherbime spedicionare,plazhe private si dhe transport te udhetareve brenda dhe juashte vendit ,etj siedo aktivitet tjeter tregtar ,sherbim prodhimi e financimi etj prodhimi e financimi etj qe dote ndikoje per rritjen ,zhvillimin dhe fuqizimin e shoqerisë. Dhënie ambjentesh me qera, si pasuri të luajtshme edhe të paluajtshme. | |
| 10. Administratori/ët | Agim Xhelilaj | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 17/05/2011 | Deri: 17/05/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| parashikimet ligjore<br>11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | | |
| 12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)-<br>12.1 Afati i emërimit | MAZARS | | |
| | | Nga: 24/06/2019 | Deri: |
| 13. Ortakët | AginXhelilaj | | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | | Para: 78.100.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 78.100,00 | | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: THE BEST CONSTRUCTION<br>E-Mail: thebestco2000@gmail.com<br>Telefon: 04250621 | | |
| 16. Statusi: | Aktiv | | |

Datë: 28/05/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 420 Rep.
Nr. 204 Kol.

**AKT MARREVESHJE**

Sot me date 15 03.2018 (dymijë e tetembedhjete), para meje Mali Y. Mallkuçi, noter ne qytetin e Tiranes, me zyre ne rrugen "Vaso Pasha" pallati 13/1, u paraqiten personalisht palet kontraktuese si me poshte :

(1) Shoqëria "**H.K HEC Grabova 2" SHPK**, person juridik shqiptar,regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe pajisur me numër identifikimi NIPT: L72023004I, më seli në adresën: Tiranë, Kashar Mezez, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 3, Rruga Themistokli Germenji, Zona Kadastrale 2679, Godina me Nr Pasurie 22/14, e përfaqësuar nga Administratori ligjor **Z.Lulzim KAPLLANAJ** atesia Isuf, i datelindjes 15.11.1984, lindur ne Fratar, Fier dhe banues ne Tirane, i identifikuar me letenjoftim nr. 030037956, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar dhe **Znj. Aurela Dollengaatesia Besim**, datelindja 10.10.1988 lindur ne Gramsh dhe banues ne Tirane, identifikuar me letenjoftim nr 024740132 madhore, me zotesi te plote juridike e per te vepruar që këtu e më poshtë do të njihet se bashku si "**Pala e Pare**"
dhe
(2) Shoqëria "**EMIKEL" SHPK**, person juridik shqiptar,regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe pajisur me numër identifikimi NIPT: K23418201C, me seli në adresën:Lagja "Emin Matraxhiu" Pallati.62, shk. A, ap.2, Elbasan, e përfaqësuar nga Administratori Ligjor **Z.Petrit Ibro**, datelindja 03.11.1955 lindur ne Lenie Gramsh dhe banues ne Lagjen Emin Matraxhiu, pallati nr. 62 Elbasan, identifikuar me letenjoftim nr F51103007R madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar që këtu e më poshtë do të njihet si "**Pala e Dyte**".

Hyrje:
Shoqeria "H.K HEC Grabova 2 " ka fituar te drejten te shfrytezojë ujin e perroit Grabovë nga kuota 1355 m.m.n.d deri ne kuoten 1002 m.m.n.d dhe nga kuota 902 m.m.n.d deri 872 m.m.n.d
Shoqëria Emikel shpk ka fituar te drejten e shfrytezimit të ujit të perroit Grabovë nga kuota 1002 m m.n.d deri në kuotën 902 m.m.n.d.
Për shfrytëzimin sa më të mirë të ujit, në kuotat e mësipërme, për interesa të zhvillimit të projektit "Grabova 2", per interesa trepaleshe te Autoritetit kontraktues, shoqerise "**H.K HEC Grabova 2" SHPK** dhe shoqerise "**EMIKEL" SHPK**, si dhe te drejtat e Shoqerise Emikel shpk ne te ardhmen mbi Centralin Lenie: lidhet kjo akt- marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve të sipërcituara.

**BAZA LIGJORE :**

Lidhja dhe zbatimi i kësaj akt marrëveshje, bazohet në dispozitat e:

1 Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë"(ndryshuar);
2 Ligji 43/2015 " Per sektorin e Energjise Elektrike";
3 Ligji nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" (ndryshuar);
4 Kontratën e Koncesionit e Formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për Ndërtimin e Hidrocentralit "GRABOVË 2", nënshkruar më datë 14.09.2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shoqërisë "H.K HEC Grabova 2"SHPK.

5. Kontratën Koncesionare e formës ROT e lidhur midis Ministrisë Ekonomisë, Ministrisë Industrisë dhe Energjitikës nga njëra anë dhe shoqërisë Emikel shpk per Hidrocentralet Lenie, Corovodë dhe Tucep të miratuar me VKM nr.152 dt. 13.03.2003.
6. Legjislacionin në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

**Duke qënë se :**

1. Shoqëria "EMIKEL" SHPK ka nënshkruar një kontratë koncesioni tip ROT me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Industrisë dhe Energjitikës me objekt "*Për hidrocentralet vendore Lenie, Corovodë, Tucep*", miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.152, datë 13.03.2003 "Për miratimin e Marrëveshjes së Koncesionit të *formës* ROT, ndërmjet Ministrisë se Ekonomisë e Ministrisë së Industrisëdhe të Energjitikës nga njëra anë, dhe Shoqërisë "Emikel" Shpk, Për Hidrocentralet vendore Lenie, Corovodë, Tucep".

2. Më datë 03.04.2013 palët e dytë kanë nënshkruar një Marrëveshje shtesë Koncesioni për "Disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen e koncesionit të formës ROT të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës dhe Shoqërisë "Emikel" Shpk, per rritjen e kapacitetit te H/C Lenia, nga 400 kë ne 1000 kë, duke shfrytezuar ujërat e tepërta të lumit Grabovë, duke vendosur një turbinë 600 kë.

3. Hidrocentrali i Lenies, ndodhet në lumin e Grabovës, në Rrethin e Gramshit, Qarku Elbasan dhe ka këto karakteristika:
   - Kapaciteti i instaluar: 0.4 MW
   - Kuota e veprës së marrjes: 1002 m m.n.d
   - Kuota e godinës së centralit 902 m m.n.d

   Ky hidrocentral është vënë në punë dhe funksionon rregullisht me kapacitet te fuqisë istaluar, dhë për tre vitet e fundit ka realizuar këto kapacitete prodhimi :
   - Viti 2014 : 3 029 280 kWh
   - Viti 2015 : 2 681 932 kWh
   - Viti 2016 : 2 980 416 kWh

4. Shoqëria "H.K HEC Grabova 2" SHPK, është shpallur fituese e procedurës konkurruese, dhe më date 14. 09.2017 ka nënshkruar kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) me objekt "Për Ndërtimin e Hidrocentralit "GRABOVË 2" me Ministrine e Infrastrukturës dhe Energjisë.
5. Sipas percaktimeve te Kontrates se Koncesionit, Hidrocentrali Grabove 2 perbehet nga Hec "Grabove 2/1" dhe Hec "Grabove 2/2", do tëshfrytezojë potencialin hidroenergjetik te pellgut ujembledhes te lumit te Graboves. Hec "Grabove2/1" dhe Hec"Grabove 2/2 parashikohen te jene te tipit me derivacion dhe do te kene parametrat kryesore hidroenergjitike si me poshte vijon:

   HEC Grabova 2/1:

   Kuotat e veprave
   - Kuota e vepres se marrjes (perroi i Mocalit) 1355 m m.n.d.
   - Kuota e godines se centralit 1002m m.n.d.
   - Fuqia e instaluar (kË) –N=7,400 kW
   - Energjia mesatare vjetore kËh - E=32,139,101.65 kWh/vit

   HEC Grabova 2/2:

   Kuotat e veprave
   - Kuota e vepres se marrjes (Ujerat e perroit te Graboves) 902. m m.n.d.
   - Kuota e godines se centralit 872 m m.n.d.
   - Fuqia e instaluar (kW) – N=700 kW

- Energjia mesatare vjetore kWh     E=3,275,336.29 kWh/vit

6. Referuar në dispozitën e Nenit 8/1 paragrafi i dytë, të Kontratës së Koncesionit të Formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për Ndërtimin e Hidrocentralit "GRABOVË 2" e nënshkruar më datë 14. 09.2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Subjektit "H.K HEC Grabova 2" SHPK, në të cilin parashikohet se:
"Ne rast se Koncesionari, do të vlerësojë si alternative fizibël, një zgjidhje teknike në të cilën përfshihet edhe funksionimi i Hec Lenie, me fuqinë dhe prodhimin aktual të përcaktuara në kontratën koncesionare respektive, pas dakortësisë me koncesionarin e HEC Lenie nëpërmjet një marrëveshje të nënshkruar mes tyre, të noterizuar dhe pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues mund të përfshijë edhe këtë HEC në skemën përfundimtare të shfrytëzimit të Lumit Grabovë."

7. Për shfrytëzim sa më të mirë të kuotave 1355 m.m.n.d deri 872 m.m.n.d sipas projektit fizibel të paraqitur nga Grabova 2, në interës të shtetit, të firmës koncesionare "H.K HEC GRABOVA 2" duke rritur kapacitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike, si dhe të shoqërisë Emikel shpk, ( H/C Lenie) duke shfrytezuar ujrat e tepërta të krijuara nga shirat e mëdha në pellgun ujembledhës brenda kuotave te me siperme (1355 – 872) dhe të sasisë së ujit që mund të dalin nga mos funksionimi i H/C Grabova 2, për interesa trepalëshe te Autoritetit kontraktues, shoqerise "H.K HEC Grabova 2" SHPK dhe shoqerise "EMIKEL" SHPK, si dhe për ruajtur të drejtat e shoqërisë Emikel shpk në të ardhmen mbi Centralin Lenie:
8. **Bazuar ne Projektin e Zbatimit Hidrocentrali Grabove 2, do të shfrytezojë potencialin hidro Energjetik të pellgut ujë mbledhes të lumit Grabovë dhe parashikohet të jetë i tipit me derivacion dhe do te ketë parametra kryesore hidroenergjitike si me poshte vijon:**
**<u>HEC Grabova 2:</u>**
Kuotat e veprës janë të paraqitura si më poshtë:
- **Kuota e veprës së marrjes (perroi i Mocalit)     1355m m.n.d.**
- **Kuota e godinës së centralit     872 m m.n.d.**
- **Fuqia e instaluar (kW) – N=10 800 kW**
- **Energjia mesatare vjetore kWh     E=40,050,723.35kWh/vit**

**Palët, me cilësinë që u njeh ligji në Republikën e Shqipërisë dhe me vullnet te lirë, bien dakord te hartojnë, nënshkruajnë dhe respektojnë këtë marrëveshje më përmbajtje si më poshtë vijon:**

**NENI 1     OBJEKTI I AKT-MARRËVESHJES**
1. Palët kanë rënë dakord që pala e parë, gjatë operimit me Hidrocentralin Grabova 2 të shfrytëzojë ujin nga lartësia 1358.00 m m.n.d deri ne kuoten 865.70 m m.n.d në mënyrë të pandërprerë e për sa kohë do funksionojë si Hidrocentral, Grabova 2 "H.K.HEC Grabova 2" sh.p.k.

2. Si pasojë e ndërtimit të Hidrocentralit Grabova 2 , burimet ujore që furnizojnë palen e dyte e qe perdoren per operim nga Hidrocentrali Lenie do devijohen plotësisht në favor të Palës së Parë (Hidrocentralit Grabova 2 ).
3. Per shkakun e devijimit te ujit me te cilin operonte pala e dyte ne H/C Lenie, pala e pare qe operon ne Hidrocentralin Grabova 2 do të kompensojë të gjithë humbjen e sasisë vjetore të Energjisë Elektrike të prodhuar nga pala e dyte ne Hidrocentralin Lenie per sa kohe do funksionoj H/C Grabova 2, duke u bazuar në shifrat e të dhënave mesatare vjetore të prodhimit të realizuar gjatë 3 viteve (2014, 2015 e 2016) të paraqitura nga Shoqëria Emikel shpk të konfirmuar nga organet kompetente shtetërore, si

dhe nje sitesë fuqie të kapacitetit te instaluar prej 200. kË (50% e prodhimit mesatar te 3 viteve te cituar me lart).

4. Sasia e Energjisë Elektrike vjetore e cila do të transferohet nga Pala e Pare, te Pala e Dyte si kompensim për shfrytezimin e rrjedhës ujore nga Pala e Pare do të jetë 4.350.000 kWh(kater milion e treqind e pesëdhjetë mijë kilovat) në total, gjate nje viti kalendarik. Sasia e Energjise Elektrike prodhuar per llogari te shoqerise Emikel shpk do te jete e rregjistruar ne matesin e shoqerise Emikel shpk, istaluar ne Box matie, më vehte, me te njejta parametra dhe karakteristika teknike si ai i shoqerise "H.K HEC Grabova 2" shpk.

5. Kompensimi i Energjisë Elektrike do fillojë vetëm pas vënies në punë të Hidrocentralit Grabova 2 dhe do të konsistojë në transferimin pjesë pjesë të gjithë sasisë totale prej 4.350.000 këhbrenda harkut kohor te një viti. Energjia e prodhuar nga pala e parë do ti trasferohet palës së dytë brënda dates 28 të çdo muaji të vitit kalendarik. Bashkëlidhur kësaj akt marrveshje do të jetë edhe Aneksi Nr.1 tabela për trasferimin e Energjise Elektrike nga pala e parë tek pala e dytë sipas vlerave të parashikuara për secilin muaj. Tabela është pjesë përbërëse e kësaj akt marrveshje dhe do të nënshkruhet nga të dy palët. Nëse Pala e pare nuk arrin ta kompensoje Palen e dyte me Energji Elektrike e parashikuar sipas Aneksit nr. 1, atëherë, pjesa e mbetur nga kompensimi i atij muaji do kryhet ne muajt pasardhes. Nese nuk kompesohet dhe muajin e dyte, nga H/C Grabova 2 sipas marreveshjes, shoqeria Emikel shpk ka te drejte te devijoje ujin nepermjete saracineskes shkarkimit per ne Centralin Lenie, per te vazhduar prodhimit te Energjise Elektrike si me parë per kompesimin e pa realizuar, shoqeria Emikel shpk do leshoje fatura Tatimore per prodhimin e pa kompesuar. Ne momentin e shlyerjes se detyrimit per energjine e pakompesuar ne favor te shoqerise "Emikel"shpk, uji rikthehet ne favor te Grabova 2.

6. Kompesimi dhe çdo e drejtë dhe detyrim tjetër lidhur me energjinë e transferuar (kompensuar) do ti përkasë H/C Lenie, njësoj sikur të ishte prodhuar nga ky Hidrocentral.

7. Pala e parë nuk konsiderohet përgjegjës për pagimin e taksave dhe tatimeve për pjesën e Energjisë Elektrike që i është kompensuar palës së dytë, e cila do të jetë përgjegjëse për këto taksa e tatime.Taksat dhe detyrimet qe rrjedhin nga prodhimi i energjise elektrike nga HEC Grabove per llogari te HEC-it Lenie, do te kryhen nga administratori i HEC-it Lenie.

8. Pala e dytë shlyen të gjitha taksat e tarifat energjitike që ka marrë përsipër në kontratën me objekt "Për hidrocentralet vendore Lenie, Corovodë, Tucep", miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.152, datë 13.03.2003 "Për miratimin e Marrëveshjes së Koncesionit të formës ROT, ndërmjet Ministrisë se Ekonomisë e Ministrisë së Industrisëdhe të Energjitikës nga njëra anë, dhe Shoqërisë "Emikel" shpk, Për Hidrocentralet vendore Lenie, Corovodë, Tucep.

9. H/C Lenie, ka të drejtë të prodhojë Energji Elektrike më vete, me burimet e mbetura ujore, reshjet dhe sasi të tjera ujore, gjatë gjithë kohës qe do funksionoje H/C Grabova 2, pa patur asnje detyrim ndaj Shoqerise " H.K HEC Grabova 2"

10. Shoqëria Emikel shpk me shpenzimet e veta, do të vendosë matesin e Energjisë Elektrike në Godinen e H/C Grabova 2, sikurse te ishte ne Godinen e H/C Lenie. Shoqeria H.K HEC Grabova 2, do te trasferoj te ky mates Energjin Elektrike sipas kushteve te parashikuar ne piken 4 dhe 5 te ketij neni, te kesaj marreveshje, Shoqeria Emikel shpk do kete akses ne linjen qe do perdore Grabova 2, sipas nje marreveshje te vecante e cila do te behet ne nje moment tjeter.

11. Hidrocentrali Grabova 2 do të trasferojë Energjinë Elektrike mujore sipas tabelës bashkëlidhur, tek matesi i energjise i cili do i perkase Hidrocentralit Lenie brenda dates 28 te çdo muaji kalendarik. Secila pale ne kete marrëveshje, do te caktoje Personat e autorizuar qe do merren me rakordimin e sasisë së trasferuar të energjisë elektrike.

12. Nëse pala e parë nuk punon per me shume se 5 (pese) dite,, ne diten e 6 (gjashte) deri ne venien ne pune te H/C Grabova 2, pala e pare nuk bën trasferimin e Energjisë Elektrike në matësin e H/C-it Lenie. Ne momentin kur Pala e Pare do te jete gati per te rivendosur ne pune H/C Grabova 2, ka te drejte qe te nderhyje per ndryshimin e rrjedhës se ujit, ne favor te H/C Grabova 2.

13. Pala e parë merr përsipër, qe ne fazen e berjes te projektit do mundesoje menyren e shkarkimit te ujit, tek baseni i presionit te H/C Lenie qe te punoje kur H.C Grabova 2 sh.p.k , sipas pikes 12 te ketij neni.

14. Kalimi i ujit nga H.K Grabova 2 sh.p.k ne favor te Hidrocentralit Lenie do te behet vetem ne rastet e parashikuara ne piken 5 ,12 e 13 te nenit 1 te kesaj kontrate.

15. Ne rastet e pikes 5, 12,13 te nenit 1 te kesaj marreveshje, per zbatimin e aneksit nr.1 te kompesimit te Energjise Elektrike mujore per ate muaj, do te veprohet sipas formules ne poshte:
Shembull konkret:
a)X eshte sasia mujore energjise qe duhet kompensuar sipas aneksit nr. 1
b)Y eshte sasia ditore e energjise qe duhet kompensuar per nje muaj te caktuar;
c)Z numri diteve sipas pikes 12 e 13 te nenit 1;
d)W eshte sasia energjise qe del nga shumezimi i Y-it me Z-n ( Y*Z=W)
dh K eshte sasia e mbetur e energjise per tu kompensuar nga H.K Grabova 2 sh.p.k per ate muaj ndaj shoqerise Emikel sh.p.k (X - W= K).
Veprimi pare X / 30 dite = Y
Veprimi dytë Y * Z= W
Veprimi trete X - Ŵ= K

16. Si pasojë e ndryshimit të projektit të Hidrocentralit Grabova 2, kapaciteti i instaluar do bëhet 9 MW dhe të gjitha aplikimet/lejet/autorizimet/licencat e nevojshme apo cdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kesaj vepre, do te merren sipas këtij ndryshimi nga ana e palës së parë.

17. Kjo Akt-Marrëveshje bëhet e vlefshme dhe hyn ne fuqi, pasi miratohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe do të zgjasë për të gjithë kohën që ekziston dhe do te funksionoje Hidrocentrali Grabova 2. Gjithashtu me konfirmimin e kesaj marreveshje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqeria "Emikel"shpk do te konsistoje mbi koncesionin e H/C Lenie persa kohe do te ekzistoje dhe funksionon H/C Grabova 2. Kjo marrëveshje mbetet e vlefshme edhe ne rastet e ndërrimit të zotëruesit apo pronarit te Hidrocentralit Grabova 2.

18. Detyrimet e parashikuara ne kete Akt Marreveshje do të jene te vlefshme edhe ne rastet kur Pala e Pare zëvendësohet ne investim nga Kreditoret apo nga shoqëri te tjera koncesionare qe do te kontraktohen nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, kur Pala e pare ka dështuar qe te perfundoje kontratën e koncesionit.

19. Shoqeria H.K.HEC Grabova dhe shoqëria "Emikel"shpk do te bashkepunojne per zgjidhjen e problemeve të përbashketa si, ndryshimet e mundshme ne marreveshjet me Ministrine pergjegjese

per energjine , kontrate koncesioni , licence e prodhimit te Energjise Elektrike , marredhenieve me OSHEE si dhe te marredhenieve te tjera qe munde të lindin per shkak te kesaj marreveshje.

20. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bëhet garantuesi i kësaj aktmarreveshje të nënshkruar midis palëve, dhe se asnjëra nga palët nuk do të jetë subjekt i ndonjë gjobe apo detyrimi për shkelje të detyrimeve kontraktore respektive si pasojë e realizimit të objektit të kësaj Akt-Marrëveshje.Ne rast se ndonjëra prej palëve kryhen veprime ne kundërshtim me detyrimet e marra përsipër ne kete aktmarrëveshje, atëherë ajo detyrohet qe te kompesoje palën tjetër per demin e shkaktuar.

## NENI 2 PËRFUNDIMI I AKT-MARRËVESHJES

2.1. Marveshja e nenshkruar dhe e miratuar nga strukturat pergjegjese eshte pjese e kontrates s/e Koncesionare dhe i nenshtrohet detyrimeve te percaktuar ne kontrate me gjithe ndryshimet e bera ne te, per shkak te kesaj marreveshje.

2.2.Palët mund të ndërpresin në mënyrë të menjëhershme dhe të njëanshme marrëveshjen, vetëm kur njëra nga palët:

a) Nuk respekton dhe/ose nuk zbaton në mënyrë të përsëritur kushtet e marrëveshjes.
b) Marreveshja nuk miratohet nga Ministria Infrastruktures dhe Energjise.

2.3. Ne këto rrethana, palët janë të detyruara t'i dërgojnë një njoftim me shkrim njëra-tjetrës për përfundim të marrëveshjes duke parashikuar shkakun, dhe mënyrën e kompensimit të dëmit, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike, për ngjarje të përmendum në këtë.nen.

## NENI 3 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

3.1 Per zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes dy palëve ne menyrë vullnetare dhe mirebesim garantuese per përmbushjen e detyrimeve do te jete Ministria pergjegjese per Energjine. Ne rast se Ministria nuk gjen nje zgjidhje te perbashket ne interes te dy paleve brenda 30 diteve kalendarike, nga dita kur është paraqitur ankimi, atëherë kompetente per zgjidhjen e saj do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

## NENI 4 FORCAT MADHORE

4.1 Asnjëra nga Palët nuk do të mbajë përgjegjësi kundrejt tjetrës për mos përmbushje të detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshje kur prodhimi , pengohet ose ndalohet në rast të ndonjë Force Madhore, te shpallur nga Qeveria si tilla apo emergjenca civile.

4.2 Për qëllime të kësaj Marrëveshje, me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje apo ndodhi që është përtej kontrollit të arsyeshëm të Palëve, e paparashikueshme, e pashmangshme, dhe që e bën të pamundur realizimin e detyrimeve të Palëve sipas kësaj Marrëveshje dhe që në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohet e pamundur në rrethanat e ndodhura, dhe përfshin, por pa u kufizuar në, luftra, kryengritje, trazira civile, tërmete, zjarre, shpërthime, stuhi, përmbytje ose kushte të tjera atmosferike të jashtëzakonshme, grevat, konfiskime apo çdo veprim tjetër nga agjensitë Qeveritare.

4.3 Çdo Palë që pjesërisht ose plotësisht nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshje, duhet t'i paraqesë një njoftim me shkrim palës tjetër lidhur me këtë fakt, duke dhënë me hollësi rrethanat e kësaj Force Madhore;

4.4 Çdo Palë që pretendon se ka Forcë Madhore duhet t'i bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për ta larguar këtë Forcë Madhore dhe do t'i paraqesë menjëherë me shkrim Palës tjetër për përfundimin ose mbarimin e shkakut të Forcës Madhore. Kjo Palë do t'i vazhdojë detyrimet e lëna pezull sa më parë të jetë e mundur pas përfundimit të ngjarjes së Forcës Madhore;

**NENI 5 EMËRIMI I PËRFAQËSUESVE DHE KORRESPONDENCA**

5.1 Palët do të emërojnë secili prej tyre një përfaqësues që do të mbajë përgjegjësi për marrëdhënien midis tyre lidhur me realizimin e objektit dhe zbatimin e akt marrëveshjes.

5.2 Palët do të njoftojnë me shkrim për emrin dhe të dhënat e tjera të përfaqësuesve të tyre. Palët gëzojnë të drejtën që në çdo kohë të ndryshojnë përfaqësuesin e tyre duke i paraqitur më parë palës tjetër një njoftim me shkrim. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

5.3 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që kërkohet ose lind si nevojë e zbatimit të kësaj marrëveshje, do të jetë me shkrim dhe mund të dërgohet dorazi me shënimet përkatëse nga sekretaritë ose protokollet e palëve, ose me postë të regjistruar elektronike me konfirmim marrje në dorëzim tek selia e palës marrëse ose në adresa të tjera të njoftuara më parë me shkrim nga palët, dhe ky njoftim ose komunikim do të konsiderohet si i dërguar rregullisht kur është marrë në dorëzim nga pala tjetër.

**NENI 6 DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

a. Për këtë marrëveshje, për aktesa si dhe për anekset e saj do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
b. Kjo marrëveshje është përgatitur në Shqip, në 5 kopje origjinale, nga një për secilën palë.
c. Pasi u lexua Akt-Marrëveshja, të dyja palët nuk patën asnje vërejtje dhe vendosën ta nënshkruajnë me vullnetin e tyre të lirë sot më datë___/___/2018.

**Për dhe në emër të:**

| | |
|---|---|
| **Shoqërisë** | **Shoqërisë** |
| **"EMIKEL" SHPK** | **"H.K HEC Grabova 2"SHPK** |
| **Emri:** | **Emri:** |
| **Z. Petrit IBRO** | **Z. Lulzim KAPLLANAJ** |
| Petrit Ibro | |
| **Pozicioni:** | **Znj. Aurela Dollenga** |
| **Administrator** | **Pozicioni:** |
| | **Administratorët** |

EMIKEL Sh.p.k. ELBASAN - ALBANIA

L72023004I H.K HEC Grabova 2 Sh.p.k TIRANË-SHQIPËRI

**N O T E R**

**Mali V. MALLKUÇI**

Aneksi Nr. 1 Kompensimi mujor energjitik i pales se pare

1. Kompensimi energjitik do kryhet pergjate nje viti kalendarike ne periudha mujore sipas shifrave parashikuese te meposhtme:

| Muaji | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Njesia matese ne KW | 423.500 | 417.000 | 414.500 | 444.500 | 422.500 | 439.500 | 236.500 | 184.500 | 231.500 | 373.000 | 374.500 | 388.500 |

1. Kompensimi i Energjisë Elektrike do fillojë vetëm pas vënies në punë të Hidrocentralit Grabova 2 dhe do të konsistojë në transferimin pjesë pjesë të gjithë sasisë totale prej 4.350.000 kËhbrenda harkut kohor te një viti. Energjia e prodhuar nga pala e parë do ti trasferohet palës së dytë brënda dates 28 të çdo muaji të vitit kalendarik. Bashkëlidhur kësaj akt marreveshje do të jetë edhe Aneksi Nr.1 tabela për trasferimin e Energjise Elektrike nga pala e pare tek pala e dytë sipas vlerave të parashikuara për secilin muaj. Tabela është pjesë përbërëse e kësaj akt marrveshje dhe do të nënshkruhet nga të dy palët. Nëse Pala e pare nuk arrin ta kompensoje Palen e dyte me Energji Elektrike e parashikuar sipas Aneksit nr. 1, atëherë, pjesa e mbetur nga kompensimi i atij muaji do kryhet ne muajt pasardhes. Nese nuk kompesohet dhe muajin e dyte, nga H/C Grabova 2 sipas marreveshjes, shoqeria Emikel shpk ka te drejte te devijoje ujin nepermjete saracineskes shkarkimit per ne Centralin Lenie, per te vazhduar prodhimit te Energjise Elektrike si me pare, per kombesimin e pa realizuar, shoqeria Emikel shpk do leshoje fature Tatimore per prodhimin e pa kompesuar. Ne momentin e shlyerjes se detyrimit per energjine e pakompesuar ne favor te shoqerise "Emikel" shpk, uji rikthehet ne favor te Grabova 2.

| Shoqëria | Shoqëria |
|---|---|
| "EMIKEL" SHPK | "H.K HEC Grabova 2" SHPK |
| Z. Petrit IBRO | Z. Lulzim KAPLLANAJ |
| Administrator | |
| | Z. Aurela Dollenga |

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 6336 Rep.
NR. 3097/3 Kol.

6A

KONTRATË SHTESË KONCESIONI
PËR
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS "BOT"
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "GRABOVË 2".

Në Tiranë, më datë 22.06./ 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noter Genci Kondi, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Rruga Kavajës, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizimin Nr.8972 Prot., datë 22.06.2018 nga Drejtoresha e Partneritetit Publik Privat në Fushën Energjetike, Znj. Etleva Kondi, e datëlindjes 29.03.1972, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga ID H25329143H.

**DHE**

Shoqëria **"H.K HEC Grabova 2"** sh.p.k, themeluar si person juridik datë 17.08.2017 dhe regjistruar në QKB datë 23.08.2017, me NUIS L72023004I, e përfaqësuar ligjërisht nga administratorët e shoqërisë Z. Lulzim Kapllanaj, i datëlindjes 15.11.1984, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta me nr.BA4214963 dhe nga Znj. Aurela Dollenga e datëlindjes 10.10.1988, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga Leternjoftimi me nr.024740182,

**të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:**

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2" lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k., me Nr.2026 Rep. & Nr. 926/1 Kol, hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 14.09.2017.

**Hyrje**

**Duke pasur parasysh që:**

... Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë ... HEC Grabova 2" sh.p.k (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit e ... "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2", me Nr.2026 Rep. & ...26/1 Kol, datë 14.09.2017 (në vijim referuar si "Kontrata e Koncesionit"):

...feruar Dokumentave Standarde të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat për Hidrocentralin "Grabovë 2", të publikuara me dt.17.5.2017, ku Autoriteti Kontraktues, me qëllim shfrytëzimin sa më optimal të pellgut ujëmbledhës të lumit Grabove, ka përcaktuar si alternativë opsionale, përfshirjen e funksionimit te hidrocentralit ekzistues "Lenie", ne skemën përfundimtare të shfrytëzimit të lumit Grabovë;

Referuar nenit 8, pika 1, paragrafi i trete i kontratës së koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim - Operim-Transferim) për ndërtimin hidrocentralit "Grabovë 2", te lidhur ndërmjet shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k (Koncesionari) dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoriteti Kontraktues), me nr.2026 Rep., nr.926/1 Kol, nenshkruar nga palët dhe hyrë në fuqi me datë 14.09.2017, në të cilin parashikohet se :

*Në rast se koncesionari, do të vlerësojë si alternativë fizibël, një zgjidhje teknike në të cilën përfshihet edhe funksionimi i HEC Lenie, me fuqinë dhe prodhimin aktual të përcaktuara në kontratën koncesionare respektive, pas dakortesisë me koncesionarin e HEC Lenie nëpërmjet një marreveshje të nënshkruar mes tyre, të noterizuar dhe pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues mund të përfshijë edhe këtë HEC në skemën përfundimtare të shfrytëzimit të lumit Grabovë;*

- Referuar Akt-Marreveshjes me nr.420 Rep., nr.204 Kol, datë 15.03.2018, ndryshuar me Deklaraten Noteriale , nr.1094 Rep. & nr.521 Kol, date 14.06.2018, të lidhur ndërmjet palëve:

*shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k*, e cila ne zbatim të kontratës së koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim- Operim-Transferim) për ndërtimin hidrocentralit "Grabovë 2", te lidhur ndërmjet shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k (Koncesionari) dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoriteti Kontraktues), me nr.2026 Rep., nr.926/1 Kol, nenshkruar nga palët dhe hyrë në fuqi me datë 14.09.2017, do të shfrytezojë ujin e lumit Grabovë nga kuota 1353.5 m.m.n.d deri në kuotën 1002 m.m.m.n.d dhe nga kuota 902 m.m.n.d deri ne kuotën 872 m.m.n.d, dhe

*shoqerisë "Emikel" sh.p.k* e cila në zbatim të kontrates së koncesionit të formës "ROT" e lidhur midis Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë nga njëra anë dhe shoqërisë "Emikel" shpk për hidrocentralet "Lenie", Corovodë dhe Tucep", miratuar me VKM nr.152, datë 13.3.2003 , e ndryshuar, ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të përroit Grabovë, nga kuota 1002 m.m.n.d deri në kuotën 902 m.m.n.d,

për shfrytëzimin sa më të mirë të ujit në kuotat e mësiperme, për interesa të zhvillimit të projektit "Grabova 2", ne baze te se cilës do të shfrytëzohet potenciali hidroenergjetik i pellgut ujëmbledhës të lumit Grabovë nga kuota 1353.5 m.m.n.d deri në kuotën 872 m.m.n.d, në mënyrë të pandërprerë;

- Mbështetur në nenin 28 "Ndryshime" të Kontratës së Koncesionit, ku në pikat 28.1 dhe 28.2, cilësohet se:
  - 28.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve,
  - 28.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo aneksove bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate; si dhe

[illegible] "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit" të [illegible] Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari [illegible] bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

[illegible] e Koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2" [illegible] nga palët, datë 14.09.2017, me Nr. 2026 Rep. & Nr. 926/1 Kol., të bëhen [illegible] e mëposhtme:

**Neni 1**

[illegible] Kontratën e Koncesionit të formës B.O.T. (Ndërtim-Operim-Transferim) "Për ndërtimin [illegible] hidrocentralit "Grabovë 2", me Nr. 2026 Rep. & Nr. 926/1 Kol., datë 14.09.2017, kudo në [illegible] të bëhen ndryshimet:

- Togfjalëshi: "Ministria e Energjisë dhe Industrisë", të zëvendësohet me togfjalëshin:"Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ".

**Neni 2**

- Pika 8.1 e nenit 8 *"Detyrimet e koncesionarit"*, ndryshohet si me poshte:

Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues për miratim projektin e zbatimit, brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj kontrate shtesë.

Në projektin e zbatimit për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2", në pellgun ujëmbledhës të lumit Grabovë të respektohet kuota nga 1353.5 m.m.n.d deri në kuotën 872 m.m.n.d. në mënyrë të pandërprerë, përsa kohë do të funksionojë si hidrocentral "Grabovë 2".

Burimet ujore që furnizojnë hidrocentralin Lenie të devijohen plotësisht për tu perdorur nga hidocentrali "Grabove 2".

**Neni 3**

Kjo Kontratë Shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata Shtesë e koncesionit u hartua në 4 (katër) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

**PALËT**

**AUTORITETI KONTRAKTUES**

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**

Përfaqësuar me Autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 8972 Prot, date 22.06.2018, nga:

**Znj. ETLEVA KONDI**

**DREJTOR**

**KONCESIONARI**

**"H.K HEC Grabova 2" Shpk**

**Z. LULZIM KAPLLANAJ**

**ADMINISTRATOR**

**Znj. AURELA DOLLENGA**

**ADMINISTRATORE**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GENTJANA BRATI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.7, RRUGA GJERGJ FISHTA,
GODINA NR.9, AP. NR. 1, HYRJA NR.1
TEL: 0682032619

# KONTRATË KONCESIONI

Nr. repertori: 806 Nr. koleksioni: 318

Tiranë më 11/06/2020

Ligjet reference:
1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Ky material përdoret nga 1 herë

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 806 Rep.
NR. 3/13 Kol.

A3020035004032440053

**KONTRATË SHTESË KONCESIONI**

**PËR**
**DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS "BOT" (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "GRABOVË 2"**

Në Tiranë, më datë 11, muaji 06, viti 2020 (dymijë e njëzetë), para meje noter G. Bruçaj, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë ..., u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 4145 Prot, datë 02.06.2020 (kopje bashkëlidhur) nga Z. Ilir Tomorr Bejtja, lindur në Elbasan, më 17.01.1966 madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftimi ID Nr.033398299, me Nr. PersonalG60117004R.

**DHE**

Shoqëria **"H.K. Grabova 2" sh.p.k**, themeluar si person juridik datë 17.08.2017 dhe regjistruar në QKB datë 23.08.2017, me NUIS L72023004I, e përfaqësuar ligjërisht nga administratorët e shoqërisë Z. Lulzim Kapllanaj, i datëlindjes 15.11.1984 madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta me Nr. BA4214963 dhe nga znj. Aurela Dollenga e datëlindjes 10.10.1988 madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga Letërnjoftimi me Nr. 024740182.

**të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:**

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim), të ndryshuar me Nr. 2026 Rep. & Nr. 926/1 Kol, për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2", lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë "H.K Hec Grabovë 2" sh.p.k hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 14.09.2017.

**dhe**

Shtesës së Kontratës Nr. 1356 Rep & 909/2 Kol për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2" lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoritetit Kontraktues) dhe shoqërisë "H.K Hec Grabovë 2" sh.p.k hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 22.06.2018.

## Hyrje

A20200530400223140353

**Duke pasur parasysh që:**

- Ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë "H.K. Grabova 2" sh.p.k është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës "BOT", e ndryshuar për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2", me Nr. 2026 Rep & Nr. 926/1 Kol, datë 14.09.2017 (në vijim referuar si Kontrata e Koncesionit).

- Kontratën shtesë të Koncesionit Nr. 1356 Rep & 909/2 Kol për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2" lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoritetit Kontraktues) dhe shoqërisë "H.K Hec Grabovë 2" sh.p.k, hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 22.06.2018.

- Shkresën e Autoritetit Kontraktues Nr. 8496/1 Prot datë 11.10.2019 "*Miratohet projekti i zbatimit i hidrocentralit Grabovë 2*" drejtuar shoqërisë "H.K Hec Grabova 2", sh.p.k, nëpërmjet të cilës Autoriteti Kontraktues (MIE) miraton projektin e zbatimit dhe shprehet i gatshëm për të nënshkruar kontratën shtesë të Koncesionit ku do të pasqyrohen ndryshimet e parametrave hidroenergjetikë të hidrocentralit "Grabovë 2" , në përputhje me projektin e zbatimit.

- Shkresën e shoqërisë "H.K. Hec Grabova 2" sh.p.k me Nr. 38 Prot. datë 13.04.2020 "*Mbi problematikat dhe vonësat e shkaktuara nga institucionet shtetërore për marrjen e lejeve të nevojshme për realizimin e Kontratës Koncesionare të formës BOT për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2*", protokolluar në MIE me Nr. 3146 Prot. datë 15.04.2020, me anë të së cilës shoqëria informon Autoritetin Kontraktues mbi vonesat e shkaktuara nga institucionet shtetërore për marrjen e lejeve, licencave dhe autorizimeve për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të shoqërisë "H.K. Hec Grabova 2" sh.p.k për ndërtimin e hidrocentralit Grabova 2", ku citohen vonesat e shkaktuara nga Bashkia Gramsh për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor, kullusor, të fondit në pronësi të Bashkisë Gramsh, vonesën e miratimit së pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes, vonesave për miratimin në parim të përdorimit të burimeve ujore, të lëshuara nga organet përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, si dhe ndryshimin e parametrave hidroenergjetikë sipas projekt zbatimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.

- Shkresën e shoqërisë "H.K. Hec Grabova 2" sh.p.k me Nr.46 Prot. datë 24.04.2020 "*Kërkesë për bashkëpunim për zgjatje afati të deklaratës mjedisore nr. 6899 Prot datë 23.08.2018 (nr. identifikim 607 dhe vendimi 37), për shkak të vonesave të shkaktuara nga institucionet*", protokolluar në MIE me Nr. 355 Prot. datë 27.04.2020, me anë të së cilës informon Autoritetin Kontraktues mbi vonesat e shkaktuara nga Bashkia Gramsh për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor, kullusor, të fondit në pronësi të Bashkisë Gramsh, vonesën e miratimit së pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes, vonesave për miratimin në parim të përdorimit të burimeve ujore, të lëshuara nga organet përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, si dhe vonesat si pasojë e situatës së pandemisë së COV 19 në të cilën aktualisht ndodhemi, duke shkaktuar pamundësi në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale sipas afatit të përcaktuar në kontratën e koncesionit;

- Shkresën e shoqërisë "H.K. Hec Grabova 2" sh.p.k me Nr. 37 Prot. datë 10.04.2020 "*Përsëritje kërkese për bashkëpunim dhe informimin e OST-së*", me anë të së cilës informon MIE-n mbi vonesat dhe pengesat në marrjen e lejeve të nevojshme të cilat janë të kushtëzuara nga miratimi i pikës së lidhjes në rrjetin [illegible] mbështetjen e MIE në mënyrë që të ndërhyjë tek OST sh.a për vijimin e procedurave për miratimin e pikës së lidhjes.

**Mbështetur në:**

Nenin 28 "Ndryshime" të Kontratës së Koncesionit, ku në pikat 28.1 dhe 28.2, cilësohet se:

- 28.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të palëve;
- 28.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur, pasi të hyjë në fuqi do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate, si dhe;

Në nenin 29 "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit

Palët bien dakord që në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2", me Nr. 2026 Rep. & Nr. 926/1 Kol, e ndryshuar me Kontratën Shtesë të Koncesionit Nr. 1356 Rep & 909/2 Kol për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Grabovë 2", nënshkruar nga palët në datën 22.06.2018, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

### Neni 1

Në nenin 1 "*Përkufizime dhe interpretime*", pika 1.6 ndryshohet si më poshtë:

në pikën 1.6, shprehja:

"....me fuqi të instaluar 8, 100 (tetëmijë e njëqind e njëzet e shtatë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 35, 414, 438 kWh (tridhjetë e pesë milion e katërqind e katërmbëdhjetëmijë e katërqind e tridhjetë e tetë)", zëvendësohet me shprehjen:

"...me fuqi të instaluar 10 800 kW (dhjetëmijë e tetëqind) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 40, 050, 723 (dyzetmilion e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) kWh".

### Neni 2

Neni 3, "*Karakteristikat e hidrocentraleve*", ndryshohet si më poshtë:

Hidrocentrali "Grabovë 2" do të shfrytëzojë pellgun ujëmbledhës të lumit të Grabovës, i cili bën pjesë në basenin e lumit Devoll, rrethi Elbasan me këto parametra hidroenergjetikë:

Hidrocentrali "Grabovë 2"

| | |
|---|---|
| ▪ Kuotat e veprave: | |
| - Vepra e marrjes nr.1 | [illegible] |
| - Vepra e marrjes nr.2 | 1358 m.m.n.d |
| - Vepra e marrjes nr.3 | 1353,3 m.m.n.d |
| - Vepra e marrjes nr.3/1 | 1355,5 m.m.n.d |
| - Vepra e marrjes nr.3/2 | 1355,3 m.m.n.d |
| - Vepra e marrjes nr.3/3 | 1353,9 m.m.n.d |
| - Kuota e godinës së centralit | 869 m.m.n.d. |
| ▪ Fuqia e instaluar (kW) | 10 800 kW |
| ▪ Energjia mesatare vjetore | 40 050 723 kWh/vit |

Të respektohet në mënyrë kategorike Akt Marrëveshja Nr. 420 Rep dhe Nr. 204 Kol, datë 15.03.2018, e nënshkruar mes shoqërisë koncensionare "H.K Hec Grabova 2" sh.p.k dhe shoqërisë "EMIKEL" sh.p.k.

**Neni 3**

Në nenin 8 *"Detyrimet e koncesionarit"*, pika 8.5 ndryshohet si më poshtë:

Në pikën 8.5, shprehja "....me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 8,100 (tetëmijë e njëqind) kW" , zëvendësohet me shprehjen "me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 10, 800 (dhjetëmijë e tetëqind) kW".

**Neni 4**

Neni 9 *"Vlerësimi i investimeve"* pika 9.1 ndryshohet si më poshtë:

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga Koncensionari janë në vlerën totale prej 1,574, 773, 440 (një miliard e pesëqind e shtatëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e dyzet) lekë me TVSH sipas preventivit bashkëlidhur kësaj kontrate shtesë.

**Neni 5**

Në nenin 10 *"Programi i Punimeve"*, pika 10.2 ndryshohet si më poshtë:

në pikën 2, shprehja: "....... Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit....", zëvendësohet me shprehjen: "....... Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi e kësaj kontrate shtesë koncesioni....".

**Neni 6**

Në nenin 14 "*Sigurimi i kontratës*", pika 14.1 ndryshohet si më poshtë:

Në pikën 14.1 shprehja "......vlerën e Sigurimit të Kontratës prej 14[illegible]qind e dyzet e tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nj[redacted] zëvendësohet me shprehjen :

"......vlerën e sigurimit të kontratës prej 157,477,344 (njëqind e pesë dhjetë e shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë.

**Neni 7**

Në nenin 23 "*Sanksionet*", pika 23.2 ndryshon si më poshtë:

në pikën 23.2. 1. shprehja ".....të prodhimit të energjisë elektrike prej 35, 414, 438 (tridhjetë e pesë milion e katërqind e katërmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e tetë) kWh/vit ", zëvendësohet me shprehjen

".....të prodhimit të energjisë elektrike prej 40, 050, 723 (dyzetmilion e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) kWh/vit".

**Neni 8**

Kjo Kontratë Shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

**PALËT**

**AUTORITETI KONTRAKTUES**

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**

Përfaqësuar me Autorizim
Nr. 4145 Prot, datë 02.06.2020
të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga:

**Z. Ilir BEJTJA**

**ZV. MINISTËR**

**SHOQËRIA KONCESIONARE**

**"H.K.Grabova 2" Sh.p.k**

Përfaqësuar nga:

**Z. Lulzim KAPLLANAJ**

**Znj. Aurela DOLLENGA**

**ADMINISTRATOR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 4145 Prot. Tiranë, më 02/06/2020

# AUTORIZIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, të neneve 29, 31, 66, 72 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 43/2015 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, *të ndryshuar*, të Ligjit Nr. 125/2013 *"Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" të ndryshuar* dhe VKM Nr. 575, datë 10.07.2013 *"Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet privat publik"*, autorizoj Z. Ilir Tomorr Bejtja, Zëvendësministër, lindur në Elbasan, më 17.01.1966, me Nr. ID. 024802385, për firmosjen e *"Kontratës Shtesë të Koncesionit për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit, të formës "BOT"(Ndërtim –Operim – Transferim) Nr. 2026 Rep., Nr. 926/1 Kol., datë 14.09.2017 për ndërtimin e hidrocentralit Grabovë 2"*, të ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit Nr. 1356 Rep., Nr. 909/2 Kol., datë 22.06.2018, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "H.K HEC Grabovë 2" sh.p.k.

**MINISTRI**

**Belinda Balluku**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L72023004I | |
| 2. Data e Regjistrimit | 23/08/2017 | |
| 3. Emri i Subjektit | B.K HEC Grabova 2 | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 17/08/2017 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 17/08/201717/08/2052 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Kashar MEZEZ Mezez, Autostrada Tirane-Durres, Km 5, Rruga Themistokli Germenji, Zona Kadastrale 2679, Godina me Nr Pasurie 22/14 | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit Grabove 2 tek autoriteti kontraktor Ministria Energjise dhe Industrise ku perfshihet financimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike. | |
| 10. Administratori/ët | Aurela Dollenga | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 23/02/2018 | Deri: 17/08/2022 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Administratori/ët | Lulzim Kapllanaj | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 18/08/2017 | Deri: 18/08/2022 |
| 13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 14. Ortakët | HYDROPOWER | |
| 14.1 Vlera e kapitalit | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| 14.2 Numri i pjesëve<br>14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | Para: 50.000,00 | Natyre: |
| | 1,00 | |
| | 50,00 | |
| 14.4 Komente (nëse ka) | | |
| 15. Ortakët | VELLEZERIT HYSA | |
| 15.1 Vlera e kapitalit<br>15.2 Numri i pjesëve<br>15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | Para: 50.000,00 | Natyre: |
| | 1,00 | |
| | 50,00 | |
| 15.4 Komente (nëse ka) | | |
| 16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: H.K HEC Grabova 2<br>Telefon: 0674004646 | |
| 18. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 11/06/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)